

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për programin e studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Private dhe Biznesi” me profile:
“E Drejtë Private” dhe “E Drejtë Biznesi”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Asoc.Dr. Enkeleda OLLDASHI
Doc.Dr. Erind MERKURI



(Prill/2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Msc. në “E Drejtë Private dhe Biznesi” me profile: “E Drejtë Private” dhe “E Drejtë Biznesi”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Juridik
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr.74, datë 21.1.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër MAS Nr.68, datë 14.02.2011
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile: “E Drejtë Private” dhe “E Drejtë Biznesi”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7 (shtatë)
16	Aktivizimi i programit të studimit	2011-2012
17	Numri i studentëve aktualë	46 studentë (viti akademik 16-17) 36 studentë (viti akademik 17-18)
	etj	

Të dhëna për programin e studimit Msc në “E Drejtë Private dhe Biznesi” me profile: “E Drejtë Private” dhe “E Drejtë Biznesi”

Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Private dhe Biznesi” me profile: “E Drejtë Private” dhe “E Drejtë Biznesi”, është hapur si program studimi me VKM Nr. 74, datë 21.01.2009 “Për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, në Shkollën e Lartë Universitare Private “Universiteti Evropian i Tiranës”. Më pas ky program studimi është akredituar me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 68, datë 14.02.2011, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit, Nr. 133, datë 21.12.2010. Gjithashtu, me urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 380, datë 12.10.2015, është bërë edhe riregjistrimi i formave të diplomave, ndër të tjera edhe për këtë program studimi, në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof.Asoc.Dr. Enkeleda Olldashi
2. Doc.Dr. Erind MERKURI

Gjatë të gjithë procedurës, GVJ, është asistuar nga Koordinatori Teknik, Znj. Ersi Dako.

Më datë 13.04.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 25/22 Prot. me lëndë “*Dërgohet Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm*”, UET është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 18.04.2018, UET përcjell në ASCAL shkresën me Nr. 10/13 Prot., me lëndë “*Dërgohen komentet në lidhje me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, shoqëruar me dokumentacionin mbështetës*”. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi lexoi me kujdes përgjigjen e UET, paraqiti argumentimin për secilin nga komentet dhe vendosi: të marrë në konsideratë dhe të reflektojë ndryshimet në RVJ për komentin 1 (fq. 1 të objeksioneve); të marrë pjesërisht në konsideratë dhe të reflektojë ndryshimet në RVJ për komentin 2 (fq. 1 dhe 2 të objeksioneve), komentin 3 (fq. 2 dhe 3 të objeksioneve) dhe komentin 5 (fq. 3 dhe 4 të objeksioneve); të mos marrë në konsideratë komentin 4 (fq. 3 të objeksioneve) dhe komentin 7 (fq. 5 dhe 6 të konkluzioneve) dhe në lidhje me komentin 6 (fq. 4 dhe 5 të objeksioneve) të bëjë një rivlerësim të rubrikës 11 duke ndryshuar konkluzionin për të nga “plotësohet pjesërisht” në “plotësohet kryesisht”.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të forcohet roli i strukturave kontrolluese për rritjen e efektivitetit sidomos në fushën e kërkimit shkencor;
- b) Në departamente të krijohen grupet mësimore kërkimore si njësi bazë për të menaxhuar më mirë si mësimdhënien ashtu edhe aktivitetin kërkimor;
- c) Fakulteti/Departamentet të shohin me përparësi rritjen e shkallës së kualifikimit të personelit akademik, që të gjithë titullarët e lëndëve të kenë gradën shkencore doktor;
- d) Institucioni të punojë për punësimin me kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësimin me kohë të plotë;
- e) Të aktivizohen më shumë ekspertë, edhe me statusin e “guest speaker”, për të realizuar më mirë shkëmbimin e përvojave edhe me universitetet e tjera por edhe me ekonominë;
- f) Në të gjitha programet të mos lejohet dhënia nga një titullar e më shumë se dy lëndëve;
- g) Të bëhet i detyrueshëm disponimi i materialit bazë (leksione të shkruara) në shqip;
- h) Të normohet numri i faqeve të leksioneve të shkruara në rreth 10-15 faqe për leksion;
- i) Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si p.sh, te programi “MNP Shkenca Komunikimi”, “MND Marrëdhënie Ndërkombëtare”, etj;
- j) Kurrikulat të përcaktojnë më qartë dhe më thjeshtë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar;
- k) Të shikohet mundësia e ngarkesave në planet mësimore për ta bërë më intensiv procesin e angazhimit të studentit (diferencime në numrin e krediteve për lëndë të veçanta);
- l) Të harmonizohet më mirë shpërndarja e mësimdhënies në kohë gjatë javës;
- m) Të vazhdohet puna e nisur me Universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht, të shtohen kontaktet me universitetet e tjera;
- n) Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë modeli perëndimor në plotësimin e përmirësimit e planeve mësimore;
- o) Të përmirësohet bashkëpunimi me universitetet në vend, për të thithur kontingjente të interesuara për ciklin e studimeve DND, MNP e MND në UET, duke ekspozuar më mirë kriteret e pranimit;
- p) Të rriten e forcohen kontaktet me punëdhënësit brenda e jashtë vendit për të rritur sigurinë e punësimit të studentët;
- q) Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase dhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze, për studentët e diplomave DND, MNP e MND;

- r) Të shihet mundësia e uljes së tarifës të studimeve duke vendosur raporte më eficiente në shpenzimet psh., reklamata publicitare, për të rritur më tej interesimin e kontigjenteve më cilësore;
- s) Të rriten të ardhurat nga aktiviteti kërkimor, duke u angazhuar në tematika që kanë interes për ekonominë e vendit tonë;
- t) Te synohet botimi i monografive me interes për institucione kërkimore shkencore brenda e jashtë vendit;
- u) Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor;
- v) Të pasurohet më tej fondi i bibliotekës edhe me literaturë të huaj dhe literaturë në shqip, kryesisht në funksion të plotësimit të nevojave të kurrikulave.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Rekomandimet e mëposhtme janë analizuar nga GVJ duke u bazuar në paraqitjen e tyre në RVB por në çdo prej rekomandimeve që nuk kanë qenë pjesë e pikave të dobëta të lëna nga GVJ e mëparshme, anëtarët e GVJ do të shprehen në rekomandimin përkatës.

a) Për rekomandimin në gjermën "a)" "*Të forcohet roli i strukturave kontrolluese për rritjen e efektivitetit sidomos në fushën e kërkimit shkencor*", GVJ konstaton që Institucioni u ka dhënë kompetenca organeve drejtuese në bazë të një hierarkie, në lidhje me të drejtën e planifikimit, organizimit, garantimit të politikave, vizionit dhe procedurave të ndjekura në UET. Roli kontrollues mbi veprimtarinë mësimore dhe kërkimin-shkencor realizohet si më poshtë:

Senati Akademik, sipas statutit të UET, ka ndër të tjera si kompetencë që të miratojë planin vjetor të veprimtarisë akademike dhe të kërkimit-shkencor, garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë, si edhe krijon mekanizma për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, (neni 19.2.7, gjermat "e", "h" dhe "i").

Rektorati është një tjetër strukturë e cila ka të drejtë që të paraqesë rekomandime për projektet dhe kërkimin shkencor si edhe monitoron vazhdimisht rezultate të veprimtarisë së IAL-së (Statuti, neni 19.3.1, gjermat "e" dhe "g"). Dekanati ka të drejtë që t'i propozojë Senatit programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor, si edhe ndryshime në programet ekzistuese, si edhe shqyrton dhe miraton raportin e Dekanit për veprimtarinë mësimore dhe të kërkimit shkencor (Statuti, neni 19.5.2, gjermat "d" dhe "j").

Rektori, i cili drejton procesin akademik dhe shkencor në UET, garanton lirinë e kërkimit shkencor, organizon kontrollin për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit-shkencor, administron kërkimin shkencor (Statuti, neni 20.3.4, gjermat "d", "i", "j" dhe "k").

Dekani i cili organizon dhe drejton aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor të fakultetit si edhe raporton në lidhje me to (Statuti, neni 20.4.2, gjermat "f" dhe "i").

Përgjegjësi i Departamentit, i cili ka në kompetencë që të organizojë, koordinojë dhe drejtojë veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore të departamentit, si edhe bën vlerësimin e pedagogëve, ku përfshihet dhe vlerësimi për aktivitetin kërkimor-shkencor (Statuti, neni 20.5.5, gjermat "a" dhe "f").

Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore-Shkencore, i cili ushtron kompetencat e tij në lidhje me kërkimin shkencor në nivel universiteti dhe përgjigjet për realizimet e anëtarëve të qendrës (Statuti, neni 20.7.5).

Gjithashtu kjo IAL ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si njësi autonome, në nivel Universiteti. Kjo strukturë sipas nenit 11 të Statutit të UET-së harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm, ku përfshihen edhe fusha e kërkimit shkencor. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UET-së. Në përfundim kjo njësi ka të drejtë të propozojë masa dhe ndryshime konkrete për përmirësimin e cilësisë.

Përsa më sipër, rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.

b) Për rekomandimin në gjermën "b)" "*Në departamente të krijohen grupet mësimore kërkimore si njësi bazë për të menaxhuar më mirë si mësimdhënien ashtu edhe aktivitetin kërkimor*", GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

c) Për rekomandimin në gjermën "c)" "*Fakulteti/Departamentet të shohin me përparësi rritjen e shkallës së kualifikimit të personelit akademik, që të gjithë titullarët e lëndëve të kenë gradën shkencore doktor*", GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

ç) Për rekomandimin në gjermën "d)" "*Institucioni të punojë për punësimin me kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësimin me kohë të plotë*", GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

d) Për rekomandimin në gjermën "e)" "*Të aktivizohen më shumë ekspertë, edhe me statusin e "guest speaker", për të realizuar më mirë shkëmbimin e përvojave edhe me universitetet e tjera por edhe me ekonominë*", GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

dh) Për rekomandimin në gjermën "f)" "*Në të gjitha programet të mos lejohet dhënia nga një titullar e më shumë se dy lëndëve*", GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

e) Për rekomandimet në gjermat (g;h;j) "*Të behet i detyrueshëm disponimi i materialit bazë (leksione të shkruara) në shqip; Kurrikulat të përcaktojnë më qartë dhe më thjeshtë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar; Të normohet numri i faqeve të leksioneve të shkruara në rreth 10-15 faqe për leksion*", GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

ë) Për rekomandimin në gjurmën “k”) “Të shikohet mundësia e ngarkesave në planet mësimore për ta bërë më intensiv procesin e angazhimit të studentit (diferencime në numrin e krediteve për lëndë të veçanta)”, GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

f) Për rekomandimin në gjurmën “l”) “Të harmonizohet më mirë shpërndarja e mësimdhënies në kohë gjatë javës”, GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

g) Për rekomandimin në gjurmën “m”) “Të vazhdohet puna e nisur me Universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht, të shtohen kontaktet me universitetet e tjera”, GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

gj) Për rekomandimin në gjurmën “n”) “Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë modeli perëndimor në plotësimin e përmirësimit e planeve mësimore”, institucioni ka ngritur disa organe këshillimore si edhe ka caktuar edhe ekspertë të jashtëm (shih dokumentin “Vendimi për caktimin e eksperteve të jashtëm”, “Procedura e ndryshimit të kurrikulave” si edhe “Përfshirja e mendimeve të studentëve dhe Bordit të Tregut të Puës për përmirësimin e kurrikulës”), me qëllim përmirësimin e programeve mësimore sipas standardeve dhe modeleve perëndimore. Përsa më sipër, rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht. **Përsa më sipër, rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.**

h) Për rekomandimin në gjurmën “o”) “Të përmirësohet bashkëpunimi me universitetet në vend, për të thithur kontingjente të interesuara për ciklin e studimeve DND, MNP e MND në UET, duke ekspozuar më mirë kriteret e pranimit”, GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

i) Për rekomandimin në gjurmën “p”) “Të rriten e forcohen kontaktet me punëdhënësit brenda e jashtë vendit për të rritur sigurinë e punësimit të studentët”, GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

j) Për rekomandimin në gjurmën “q”) “Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase dhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze, për studentët e diplomave DND, MNP e MND”, GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

k) Për rekomandimin në gjurmën “r”) “Të shihet mundësia e uljes së tarifës të studimeve duke vendosur raporte më efikente në shpenzimet psh., reklamat publicitare, për të rritur më tej interesimin e kontigjenteve më cilësore”, GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

l) Për rekomandimin në gjurmën “s”) “Të rriten të ardhurat nga aktiviteti kërkimor, duke u angazhuar në tematika që kanë interes për ekonominë e vendit tonë”, GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

m) Për rekomandimin në gjurmën “t”) “Të synohet botimi i monografive me interes për institucione kërkimore shkencore brenda e jashtë vendit”, GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

n) Për rekomandimin në gjurmën “u”) “Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor”, GVJ konkludon që ky rekomandim nuk lidhet me këtë program studimi.

nj) Për rekomandimin në gjurmën “v”) “Të pasurohet më tej fondi i bibliotekës edhe me literaturë të huaj dhe literaturë në shqip, kryesisht në funksion të plotësimit të nevojave të kurrikulave”, Institucioni është kujdesur për pasurimin e bibliotekës. Për këtë qëllim është formalizuar një procedurë për planifikimin e blerjeve të reja çdo vit, si edhe janë bërë dhe abonime në biblioteka online. **Përsa më sipër, rekomandimi konsiderohet i plotësuar plotësisht.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Neni 6 i Statutit të UET jep misionin dhe vizionin e kësaj IAL. Sipas këtij dokumenti zyrtar, misioni i këtij institucioni është ofrimi i një edukimi cilësor i kombinuar me rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm. Ky mision synohet të arrihet përmes mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe ndërtimit të partneriteteve me tregun e punës.

Statuti i Universitetit është rishikuar në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë dhe është miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 90, datë 28.02.2017 “Për miratimin e statutit të Universitetit Europian të Tiranës”. Në këtë dokument kryesor të institucionit parashikohet dhe veprimtaria e brendshme e institucionit, organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese dhe vendimmarrëse si dhe veprimtaria akademike dhe shkencore e tij. Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se aktet e tjera në zbatim të Statutit nuk janë miratuar ende (takimi me Rektorin e UET). Këto akte si: Rregullorja e UET dhe rregulloret e programeve të studimit janë në fazën e hartimit.

Aktet e brendshme ekzistuese pasqyrojnë strategjinë e zhvillimit të institucionit si dhe të drejtat dhe detyrat e personelit akademik dhe administrativ, funksionimin e programeve të studimit...etj.

Në faqen zyrtare të UET-së gjenden objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe ato afatgjata të institucionit. Ky informacion ndihmon në një zhvillim të qëndrueshëm të planifikuar e të mirëmenduar përgjatë zhvillimit të programit/eve si dhe në përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen.

Vlerat që UET kërkon të transmetojë nëpërmjet dijes në programin Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile, fillojnë strukturohen që në momentin e parë të kontaktit të studentit, nëpërmjet procesit të orientimit të tij. Për këtë qëllim është përgatitur Guida e Studentit, një dokument i mirë-strukturuar dhe i detajuar në informacione.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Private dhe Biznesi” me dy profile (E Drejtë Private dhe e Drejtë Biznesi), i ofruar nga Departamenti i së Drejtës Private është në përputhje me misionin e Institucionit, i cili lidhet më së shumti me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Ky program studimi synon të ofrojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohuri të thelluara në fushën e të drejtës private e fokusuar sipas dy profileve kryesore të kësaj fushe: në të drejtën tregtare dhe civile; - aftësi për kërkim të avancuar shkencor; - aftësim për zhvillim karriere; - parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluara me ligj; - vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë (doktoratës). <p>Ky program studimi i jep mundësi studentëve të kenë akses në profesionet si: avokat apo noter, juristë në administratë publike, juristë në firma/biznese private, juristë në sistemin bankar si dhe të vijojnë studimet e tyre edhe më tej për në Shkollën e Magjistraturës.</p> <p>Programi i studimit është konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si: plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, kreditet (ECTS), metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara.</p> <p>Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ruajë ato vlera kulturore kombëtare që lidhen në mënyrë më të drejtpërdrejtë me këtë program studimi.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi”, i ofruar nga Departamenti i së Drejtës Private është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit (sipas RVB-së), e cila synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritjen e investimeve dhe burimeve financiare për mësimdhënien, për inovacionin dhe punën kërkimore shkencore; - shtimin e stafit akademik me pedagogë me eksperiencë dhe/apo me formim në universitete të huaja prestigjioze; - Zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në shërbim të nevojave dhe prioriteteve të zhvillimit të vendit; - Përditësimin të kurrikulës sipas nevojave të tregut;

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.




	- Përdorimin e sistemit antiplagjaturë EPHORUS dhe të sistemit LMS (Learning Management System).
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi” me dy profile: “E drejtë private dhe e Drejtë Biznesi”, është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat lidhen me fushën e studimit, emërtimin e programit, nivelin dhe kapacitetet akademike të njesisë ku zhvillohet ky program studimi (Msc). Ky program studimi Msc. është në përputhje dhe me emërtimin e titullit të diplomës përkatëse (të realizuar për dy vite akademike me 120 ECTS gjithsej).</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Programi i studimit Msc. synohet të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes monitorimit të zhvillimit të procesit mësimor në auditor në aspektin formal të tij dhe në aspektin përmbajtësor të tij. Këto monitorime kryhen nga ana: autoriteteve drejtuese (në lidhje me mirëfunksionimin e programit në tërësinë e tij), personelit të sekretarisë mësimore (në lidhje me realizimin e tij në aspektin formal), përgjegjësi i departamentit (nëpërmjet vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies) si dhe nga studentët (nëpërmjet pyetësorëve). Rezultatet u bëhen me dije anëtarëve të personelit akademik me qëllimin e nxitjes së përmirësimit të procesit akademik.</p> <p>Fokus grupet me studentët ekselentë vlejné për të marrë informacion më të detajuar në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor si dhe problematikat e tjera që ata gjykojnë të arsyeshme t’ju bëhen me dije drejtuesve të programit dhe të institucionit (sipas procesverbalit të datës 31.01.2017, të aksesuar gjatë vizitës së GVJ-së në institucion).</p> <p>Gjithashtu institucioni emëron në mënyrë periodike ekspertë të jashtëm të cilët bëjnë një vlerësim të pavarur të programit të studimit dhe të programeve të lëndëve mësimore duke ofruar rekomandimet e tyre.</p> <p>Me anë të akteve të brendshme, është bërë një rishikim i lëndëve që aktualisht ofrohen në këtë program studimi. Ky ndryshim është bërë në bazë të kapaciteteve akademike të departamentit, kërkesave të studentëve dhe kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Në aktet e brendshme të institucionit, të cilat janë në fazën e hartimit, parashikohet dhe riorganizimi i programit 5 vjeçar në Drejtësi (sipas informacionit të dhënë gjatë takimit në institucion).</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit Msc. “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me profile “E Drejtë Private” dhe “E Drejtë Biznesi”, është konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si: plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, kreditet (ECTS), metodat e vlerësimit dhe kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara. 2. Përdorimi i sistemit antiplagjaturë EPHORUS dhe i sistemit LMS (Learning Management System) janë instrumente akademik të standardizuar që vlejné edhe për këtë program studimi Msc, në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. 3. Ky program studimi ofron njohuri të thelluara në fushën e të drejtës private, duke mundësuar aftësi për kërkim të avancuar shkencor, aftësim për zhvillim karriere, parapërgatitje për licencën e profesioneve të rregulluara me ligj në këtë fushë (avokati, noteri, përmbarues gjyqësor, etj) 4. Programi i studimit Msc. përmes konsultimeve mes stafit akademik dhe studentëve synon të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme në aspektin formal dhe përmbajtësor të tij. 	

5. Krijimi i “Fokus Grupeve” me studentët më të mirë, nxit frymën akademike të bashkëpunimit mes tyre dhe stafit akademik.

Standardet plotësohen plotësisht.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Universiteti European i Tiranës (UET-i) në strukturën e tij akademike ka tre fakultete, si më poshtë:

1) Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë me këto departamente: Departamenti Financës dhe Ekonomiksit; Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut; Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Statistikës;

2) Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit me këto departamente: Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun; Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara; Departamenti i Edukimit;

3) Fakulteti Juridik me dy departamente dhe një qendër studimore:

- **Departamenti i të Drejtës Private, i cili ofron këto programe: Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me dy profilet: a) E Drejtë Private; b) E Drejtë Biznesi;**

- Departamenti i të Drejtës Publike, i cili ofron këto programe: Master i Shkencave “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”, me tre profilet: a) E Drejtë Penale; b) E Drejtë Publike dhe Kushtetuese c) E Drejtë Ndërkombëtare dhe Europiane dhe Master Profesional në “Drejtësi”, me tre profilet: a) E Drejtë Administrative; b) E Drejtë Ndërkombëtare; c) E Drejtë Europiane.

- Qendra e Studimeve Ligjore “Ligji, Norma, Tradita” - kjo qendër është në funksion të mësimdhënies: hartimit dhe përditësimit të programeve të studimit, organizimit të leksioneve të hapura, organizimit të aktiviteteve shkencore që thellojnë tematika të trajtuara në leksione (klube studentore, gjyqe imituese).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

UET ofron 10 programe në Ciklin e Parë të Studimeve (Bachelor); 10 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (Msc), 11 programe të Ciklit të Dytë Master Profesional (MP); dhe 3 programeve të Ciklit të Tretë (Doktoraturë).

Departamenti i së Drejtës Private (për vitin akademik 2016-2017), përbëhet nga 15 pedagogë efektivë dhe me kontratë. Nga 15 pedagogët që janë të angazhuar në këtë departament në të gjitha ciklet e studimit: 10 pedagogë janë personel akademik efektiv (PAE), kurse 5 janë personel akademik me kontratë (PAK). Këto të dhëna janë sipas RVB-së (tabela 1 faqe 18). Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” për vitin akademik 2017-2018, semestri i parë, në nivel departamenti, përbëhet nga 15 pedagogë: 11 pedagogë efektivë (PAE) dhe 4 (PAK).

Për të dhënat e tjera në lidhje me përbërjen e stafit akademik për vitet 2011-2017, referohuni tek faqja 12 e këtij raporti.

Në programin e studimit Msc. “E Drejtë Private dhe Biznesi” janë dy profilet: a) E Drejtë Private; b) E Drejtë Biznesi. Në këtë program studimi gjatë vitit akademik 2016-2017 është organizuar dhe krijimi i dy grup lëndësh (ky informacion u sigurua nga GVJ gjatë vizitës dhe takimit më drejtuesit e strukturave përkatëse: takimi me drejtuesit e fakultetit). Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton ndryshime në përbërjen e stafit akademik ndër vitet akademike që janë objekt i këtij riakreditimi (2011-2017). Këto ndryshime janë bërë duke ruajtur standardet akademike në lidhje me titujt dhe gradat shkencore që stafi akademik efektiv duhet të ketë.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Universiteti Evropian i Tiranës në strukturën e tij akademike ka tre fakultete dhe secili nga këto fakultete ka së paku nga tre departamente, me përjashtim të fakultetit juridik, si cili ka dy departamente dhe një qendër studimore, si më poshtë:</p> <p>- Departamenti i të Drejtës Private, i cili ofron këtë program studimi: Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me dy profilet: a) E Drejtë Private; b) E Drejtë Biznesi;</p> <p>- Departamenti i të Drejtës Publike, i cili ofron këto programe: Master i Shkencave “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”, me tre profilet: a) E Drejtë Penale; b); E Drejtë Publike dhe Kushtetuese c) E Drejtë Ndërkombëtare dhe Europiane dhe Master Profesional në “Drejtësi”, me tre profilet: a) E Drejtë Administrative; b) E Drejtë</p>

	<p>Ndërkombëtare; c) E Drejtë Europiane. - Qendra e Studimeve Ligjore “Ligji, Norma, Tradita”.</p> <p>Departamenti i së Drejtës Private, në të cilin bën pjesë dhe programi i studimit Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me dy profilet: a) E Drejtë Private; b) E Drejtë Biznesi, ka aktualisht (për vitin akademik 2017-2018, semestri i parë) gjithsej 15 pedagogë efektivë dhe me kontratë - 11 pedagogë janë personel akademik efektiv (PAE), kurse 4 janë personel akademik me kontratë (PAK). Nga 11 pedagogët efektivë: 4 prej tyre kanë gradën shkencore dhe titullin akademik “Prof. Asoc” dhe 3 prej tyre kanë gradën shkencore (Dr).</p> <p>Për vitin akademik 2016-2017, Departamenti i së Drejtës Private, në të cilin bën pjesë dhe programi i studimit Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi”, kanë qenë të angazhuar në 10 pedagogë efektivë (PAE) dhe 5 me kontratë (PAK).</p> <p>Nga personeli PAE 4 kanë titullin akademik Prof.Asoc, 1 gradën shkencore “Doktor”, 1 është doktorant dhe 4 Msc (sipas Tabeles 1.1 të RVB-së, fq.18).</p>
--	--

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Departamenti zhvillon mbledhje të përvajshme, në lidhje me çështjet dhe problematikat e ndryshme që lidhen me mbarëvajtjen e zhvillimit të programeve të studimit. Funksionet dhe detyrat e Departamentit përcaktohen në Statutin e institucionit.</p> <p>Departamenti si njësi bazë propozon kërkesat kualifikuese dhe profilin profesional të pedagogëve që do të angazhohen në programin, në përputhje me ngarkesën mësimore dhe profilin e lëndëve që ofrohen në këtë program studimi. Përgjegjësi i departamentit bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit gjatë vitit akademik. Gjatë vizitës së institucionit, GVJ u njoh me dosjet e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi si dhe në mënyrë më specifike me raportet e vlerësimit të bërë nga Përgjegjësi i Departamentit. Disa nga këto raporte vlerësimi ishin më të detajuara dhe me komente përkatëse, në lidhje me performancën e pedagogut në auditor.</p> <p>Sipas nenit 44 të Statutit të UET rezultoi se rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të konkurimit. Kriteret bazë përcaktohen nga njësi përgjegjëse dhe miratohen nga ana e Rektorit. Me pas është Rektori i cili ngrë komisionin që zhvillon procedurën e konkurimit. Sipas RVB-së (fq.19) Përgjegjësi i Departamentit është anëtar i këtij komisioni.</p>
--	---

<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Sipas akteve të UET (Statuti) rezultoi se rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të konkurimit dhe kriteret bazë të përcaktuara nga njësi përgjegjëse. Këto kriteret më pas miratohen nga autoriteti më i lartë drejtues i Institucionit (Rektori). 2. Universiteti Europian i Tiranës në strukturën e tij akademike ka tre fakultete ku dy nga këto fakultete kanë tre departamente. Fakulteti Juridik ka në përbërjen e tij dy departamente dhe një qendër studimore. 3. Në departamentin ku është organizuar programi i studimit Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi”, me dy profilet: a) E Drejtë Private; b) E Drejtë Biznesi, për vitin akademik 2016-2017 kanë qenë të punësuar me kohë të plotë (PAE) 10 pedagogë, ndërsa me kontratë (PAK) 5 pedagogë. Për vitin akademik 2017-2018, semestri i parë, janë të punësuar 11 me kohë të plotë (PAE) dhe 4 me kontratë (PAK). 4. Për vitin akademik 2017-2018, semestri i parë, nga 11 pedagogët efektivë: 4 prej tyre kanë gradën shkencore dhe titullin akademik “Prof. Asoc” dhe 3 prej tyre kanë gradën shkencore (Dr). Për vitin akademik 2016-2017 nga 10 pedagogët efektivë, 4 prej tyre kanë gradën shkencore dhe titullin akademik “Prof. Asoc” dhe 1 prej tyre ka gradën shkencore (Dr). 	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Për realizimin e programit të studimit, Institucioni ka angazhuar një staf akademik të përbërë me personel efektiv dhe me kontratë. Për vitin akademik 2016-2017, për këtë program studimi nga ana e institucionit janë angazhuar 7 anëtarë PAE dhe 5 anëtarë PAK. Përsa i përket raportit midis gjinive, për programin e studimit, rezultojnë se anëtarë PAE janë 3 anëtarë meshkuj dhe 4 anëtare femra. Ndërsa nga anëtarët PAK, janë 2 anëtarë meshkuj dhe 3 anëtare femra. Për vitin akademik 2017-2018, sipas të dhënave për semestrin e parë dhe të planifikimit për semestrin e dytë, rezultojnë se nga institucioni do të angazhohen 9 PAE dhe 3 PAK. Përsa i përket raportit midis gjinive, për programin e studimit, rezultojnë se anëtarë PAE janë 3 anëtarë meshkuj dhe 6 anëtare femra. Ndërsa nga anëtarët PAK, janë 2 anëtarë meshkuj dhe 1 anëtare është femër. Nga verifikimi dhe konstatimet në institucion rezultojnë se të gjithë anëtarët kanë kontrata të rregullta dhe të plota si edhe njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Për shkak të paraqitjes në RVB vetëm të të dhënave të plota në lidhje me gjininë e stafit akademik PAE dhe PAK, GVJ po pasqyrojnë në lidhje me këto të dhëna vetëm ato të vitit 2016-2017. Të dhënat në lidhje me përbërjen e stafit dhe titujt akademik dhe gradat shkencore për vitet 2011-2018, GVJ kërkoi dhe aksesoi gjatë vizitës të dhënat e nevojshme (në mënyrë të detajuar gjenden në faqet 11-12 të këtij raporti).

Numri total i personelit administrativ të angazhuar në nivel institucional për vitin 2016-2017 është 68. Ky staf mbështetës nëpërmjet veprimtarisë teknike, administrative dhe materiale, stafin akademik, si edhe mirëfunksionimin e shërbimeve të tjera në këtë institucion. Për vitin akademik 2017-2018 numri i personelit administrativ është 52.

Ngarkesa e personelit akademik të UET-it përfshin ngarkesën në veprimtarinë mësimdhënëse, në veprimtarinë shkencore, si dhe në angazhime të tjera administrative. Pjesë e ngarkesës janë dhe veprimtaritë në kualifikimin e vazhdueshëm profesional.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Fakulteti Juridik është një ndër tre fakultet e Universitetit Europian të Tiranës dhe në përbërje të tij janë dy Departamente dhe një Qendër, konkretisht: Departamenti i së Drejtës Publike, Departamenti i së Drejtës Private dhe Qendra e Studimeve "Ligji, Norma, Tradita".

Departamentet kanë në përbërjen e tyre disa grup-lëndësh. Në departamentin e të Drejtës Private ku bën pjesë dhe programi i studimit Master i Shkencave "E Drejtë Private dhe Biznesi", me dy profilet: a) E Drejtë Private; b) E Drejtë Biznes, janë dy grup lëndësh: grup-lëndët "E drejta civile" dhe "E drejta tregtare".

Në këshillin shkencor të këtij departamenti bëjnë pjesë:

Hermion Braho	Prof. Asoc. Dr.	Përgjegjës Departamenti
Endirë Bushati	Prof. Asoc. Dr.	Anëtare (Përgjegjëse grup-lëndësh)
Edi Spaho	Prof. Asoc. Dr.	Anëtar (Përgjegjës grup-lëndësh)

(Tabela 1)

Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës në institucion kërkoi të njihet me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi për të gjithë periudhën e vlerësimit (2011-2018). Dokumentacioni përkatës u mundësua nga strukturat përkatëse të institucionit dhe GVJ e aksesoi këtë informacion në funksion të hartimit të këtij raporti. (Tabela 3). Nga të dhënat e dokumentacionit rezultojnë:

- Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc "E Drejtë Private dhe Biznesi" për vitin akademik 2011-2012 përbëhej nga: 9 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 6 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Private (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 3 janë pjesë e strukturave të tjera të Fakultetit Juridik; nga personeli PAE 1 ka titullin akademik Prof.Asoc, 4 gradën shkencore "Doktor" dhe 4 Msc. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhej nga 2 pedagogë. Raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 82% me 18%. (Tabela 3/1).
- Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc "E Drejtë Private dhe Biznesi" për vitin akademik 2012-2013 përbëhej nga: 8 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 5 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Private (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 3 janë pjesë e strukturave të tjera të Fakultetit

Juridik; nga personeli PAE 1 ka titullin akademik Prof.Asoc, 4 gradën shkencore “Doktor” dhe 3 Msc. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga 2 pedagogë. Raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 80% me 20% (Tabela 3/2).

- Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” për vitin akademik 2013-2014 përbëhet nga: 8 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 5 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Private (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 3 janë pjesë e strukturave të tjera të Fakultetit Juridik; nga personeli PAE 1 ka titullin akademik Prof.Asoc, 3 gradën shkencore “Doktor” dhe 4 Msc. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga 4 pedagogë. Raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 67% me 33% (Tabela 3/3).
- Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” për vitin akademik 2014-2015 përbëhet nga: 6 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 5 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Private (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 3 janë pjesë e strukturave të tjera të Fakultetit Juridik; nga personeli PAE 1 ka titullin akademik Prof.Asoc, 2 gradën shkencore “Doktor” dhe 3 Msc. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga 7 pedagogë. Raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 46% me 54% (Tabela 3/4).
- Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” për vitin akademik 2015-2016 përbëhet nga: 7 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 6 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Private (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 1 është pjesë e strukturave të tjera të Fakultetit Juridik; nga personeli PAE 4 kanë titullin akademik Prof.Asoc, 2 gradën shkencore “Doktor” dhe 1 Msc. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga 3 pedagogë. Raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 70% me 30% (Tabela 3/5).
- Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” për vitin akademik 2016-2017 përbëhet nga: 7 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët 5 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Private (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 2 janë pjesë e strukturave të tjera të Fakultetit Juridik; nga personeli PAE 1 ka titullin akademik “Profesor”, 4 kanë titullin akademik Prof.Asoc, 2 gradën shkencore “Doktor”. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga 3 pedagogë. Raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 58% me 42% (Tabela 3/6).
- Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” për vitin akademik 2017-2018, në semestrin e parë, për të cilën përfshihen të dhëna të plota, përbëhet nga 9 pedagogë: 8 pedagogë efektivë (PAE) dhe 1 të jashtëm (PAK). Nga PAE 6 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Private (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 2 janë pjesë e strukturave të tjera të Fakultetit Juridik; nga personeli PAE, 1 ka titullin akademik “Profesor”, 3 kanë titullin akademik Prof.Asoc, 4 gradën shkencore “Doktor”. Personeli akademik me kontratë (PAK), për këtë semestër, përbëhet nga 1 pedagog, nga të cilët 1 ka titullin akademik “Profesor”. Raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 89% me 11%. (Tabela 3/7)
- Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” për vitin akademik 2017-2018, përfshirë planifikimin për semestrin e dytë, i cili mund të jetë objekt rishikimi, përbëhet nga 12 pedagogë: 9 pedagogë efektivë (PAE) dhe 3 (PAK). Nga PAE 6 janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Private (ku është i organizuar ky program studimi) dhe 3 janë pjesë e strukturave të tjera të Fakultetit Juridik; nga personeli PAE 1 ka titullin akademik “Profesor”, 4 ka titullin akademik Prof.Asoc, 4 gradën shkencore “Doktor”. Personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga 3 pedagogë, nga të cilët 1 ka titullin akademik “Prof.Asoc.” dhe 2 kanë gradën shkencore “Doktor”. Raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 75% me 25%. (Tabela 3/8)

Nga të dhënat e administruara në institucion, rezultojnë se personeli akademik i aktivizuar në këtë program studimi, është i aktivizuar pjesërisht në programin e studimit “Bachelor” dhe pjesërisht edhe në programin e studimit Master i Shkencave që mbulohet nga Departamenti i së Drejtës Publike. Duke e ndarë personelin akademik sipas lëndëve rezultojnë se, sipas dokumentave “Aneks/Shtojcë Ngarkesa e stafit Msc. E Drejtë Private dhe Biznesi me profile, Universiteti Europian i Tiranës” dhe “Ngarkesa në auditor akademik 2016-17”, rezultojnë se personeli akademik efektiv është i angazhuar në këto lëndë:

- o Prof.Dr. Adrian Papajani, jep mësim në lëndët “Metodat e kërkimit në shkencat juridike (Msc)” dhe “E drejta e migracionit dhe refugjatit (Msc)”.
- o Prof.Asoc.Dr. Edi Spaho, jep mësim në lëndët “E drejtë tregtare (Bsc)”, “E drejtë e korporatave (Msc)” dhe “E drejtë e konkurrencës (Msc)”.
- o Prof.Asoc.Dr. Endirë Bushati, jep mësim në lëndët “E drejtë e detyrimeve (Bsc)”, “E drejtë civile II (Bsc)” dhe “Studime të avancuara në të drejtë private (Msc)”.
- o Prof.Asoc.Dr. Hemion Braho, jep mësim në lëndët, “E drejtë civile (Bsc)”, “Filozofi e së drejtës (Bsc)”, “E drejtë ndërkombëtare private (Bsc)” dhe “E drejtë bankare (Msc)”.
- o Prof.Asoc.Dr. Juelda Lamçe, jep mësim në lëndët “E drejtë familjare (Bsc)”, “E drejtë civile e krahasuar (Msc)”, dhe “E drejtë pronësisë intelektuale në BE (Msc)”.
- o Dr. Blerta Aliu, jep mësim në lëndët “E drejtë e punës dhe e sigurimeve (Bsc)”, “Çështje të së drejtës ekonomike (Msc)”, “E drejtë e falimentit dhe arbitrazhit (Msc)” dhe “Studime të avancuara në të drejtën e punës dhe sigurimit” (Msc).
- o Ph.D. Evelina Çela, jep mësim në lëndën “Çështje të së drejtës ekonomike (Msc).

Ndërsa personeli akademik me kontratë është i angazhuar në këto lëndë:

- Prof.Dr. Ilir Mustafaj, jep mësim në lëndët “E drejtë e procedurës civile (Bsc)”, “Pasuritë e paluajtshme (Msc)” dhe “Procedurë civile e karahasuar (Msc)”.
- Dr. Irena Lavdari, jep mësim në lëndën “E drejtë tatimore dhe doganore (Msc)”.
- Dr. Sokol Berberi, jep mësim në lëndën “Teknikë legjislative (Msc)”.
- Kleopatra Maliqi (Doktorante), jep mësim në lëndën “Teknikë legjislative (Msc)”.
- Evelina Koldashi (MBA), jep mësim në lëndën “e drejtë tatimore dhe doganore (Msc)”.

Duke e ndarë personelin akademik sipas lëndëve rezultojnë se, sipas dokumentave “Ngarkesa në auditor, semestri i parë, viti akademik 2017-18”, rezultojnë se personeli akademik efektiv është i angazhuar në këto lëndë:

- Prof. Dr. Adrian Papajani: Metoda kërkimi në shkencat juridike (Msc) dhe E drejta e migracionit dhe refugjatit (Msc)
- Dr. Blerta Aliu: E drejtë e punës dhe sigurimeve (Bsc) dhe Studime të avancuara në të drejtën e punës dhe sigurimeve (Msc)
- Prof.As. Edi Spaho: E drejtë tregtare (Bsc) dhe E drejtë e Korporatave (Msc);
- Prof.As. Endirë Bushati: E drejta e detyrimeve (Bsc) dhe Studime të avancuara në të drejtën private (Msc)
- PhD. Evelina Çela: E drejta e falimentit dhe arbitrazhi (Msc)
- Prof.Dr. Ilir Mustafaraj: E drejtë e procedurës civile (Bsc) dhe Pasuritë e paluajtshme (Msc)
- Prof.As. Juelda Lamçe: E drejtë civile e krahasuar (Bsc) dhe E drejtë e pronësisë intelektuale në BE (Msc)
- PhD. Renata Kau: Studime të avancuara në të drejtën e punës dhe sigurimeve (Msc) dhe E drejta e procedurës civile (Bsc)
- Dr. Ledinë Mandija: E drejta e falimentit dhe arbitrazhi (Msc) dhe E drejtë e procedurës civile (Bsc).

Në lidhje me ngarkesën në orë, referojuni tabelave 3/9 dhe 3/10 si bashkëlidhje e këtij raporti.

Raporti i pedagogëve për vitin akademik 2016-2017, në lidhje me titullin akademik Prof është: 1/1 për personelin akademik efektivë në raport me personelin me kontratë. Raporti i pedagogëve në lidhje me titullin akademik Prof.Asoc është: 4/0 për personelin akademik efektivë në raport me personelin me kontratë. Raporti i pedagogëve në lidhje me gradën shkencore Dr është: 2/2 për personelin akademik efektivë në raport me personelin me kontratë. Raporti i pedagogëve në lidhje me Masterin shkencor (Msc) është: 0/2 për personelin akademik efektivë në raport me personelin me kontratë.

Personeli akademik efektivë, sipas moshës përbëhet nga: 1 Profesor në moshën 56-65; 1 Prof.As në moshën 25-35; 3 Prof.As në moshën 36-45; 2 Dr/PhD në moshën 25-35.

Personeli akademik me kontratë, sipas moshës përbëhet nga: 1 Profesor në moshën 46-55; 1 Dr/PhD – 36-45; 1 Dr/PhD – 46-55; 1 Msc - 36-45; 1 Msc – 46-55.

Personeli administrativ, sipas moshës 42 në moshën 25-35; 13 në moshën 36-45, 8 në moshën 46-55 dhe 5 në moshën 56-65.

Raporti i pedagogëve për vitin akademik 2017-2018, semestri 1, në lidhje me titullin akademik Prof është: 1/1 për personelin akademik efektivë në raport me personelin me kontratë. Raporti i pedagogëve në lidhje me titullin akademik Prof.Asoc është: 3/0 për personelin akademik efektivë në raport me personelin me kontratë. Raporti i pedagogëve në lidhje me gradën shkencore Dr/PhD është: 4/0 për personelin akademik efektivë në raport me personelin me kontratë.

Raporti i pedagogëve për vitin akademik 2017-2018, duke marrë parasysh edhe planifikimin për semestrin e dytë, i cili mund të jetë objekt rishikimi dhe ndryshimi, në lidhje me titullin akademik Prof është: 1/1 për personelin akademik efektivë në raport me personelin me kontratë. Raporti i pedagogëve në lidhje me titullin akademik Prof.Asoc është: 4/0 për personelin akademik efektivë në raport me personelin me kontratë. Raporti i pedagogëve në lidhje me gradën shkencore Dr/PhD është: 4/2 për personelin akademik efektivë në raport me personelin me kontratë.

(shiko Tabelat 4/1 – 4/8)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Nga ana e Institucionit rezultojnë se ka një personel të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës akademik i cili mundëson zhvillimin normal të procesit të mësimdhënies si edhe realizimin e shërbimeve në favor të studentëve.
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillimin të institucionit.	Angazhimi i tyre është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, si edhe me vizionin dhe misionin që ka UET.
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar dispozitave të statutit, rezulton se përgjegjësi i Departamentit dhe përgjegjësi i grup-lëndëve kanë si detyrë dhe hartimin e kurrikulës së programit të studimit. Për hartimin e programit të lëndëve janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë stafi përkatës akademik. Nga verifikimi i mëtejshëm në institucion, nga ku rezulton që zhvillohen mbledhje javore të anëtarëve të Departamentit, si edhe nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë rezulton se personeli akademik përfshihet në hartimin e kurrikulës dhe propozimet e tyre zënë peshën e duhur në organizimin e programit përkatës të studimit.</p> <p>Sipas nenit 44 të Statutit të UET rezulton se rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të konkurimit. Kriteret bazë përcaktohen nga njësia përgjegjëse dhe miratohen nga ana e Rektorit. Më pas është Rektori i cili ngre komisionin që zhvillon procedurën e konkurimit. Sipas RVB-së (fq.19) Përgjegjësi i Departamentit është anëtar i këtij komisioni. Nga këto të dhëna rezulton se rekrutimi i personelit bëhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.</p>
--	--

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Për shkak të ndryshimeve ligjore, aktualisht nga ana e UET është hartuar dhe miratuar vetëm Statuti i këtij Institucioni. Nga vizita dhe takimet që GVJ zhvilloi në zyrën e personelit, rezultoi se rekrutimi i personelit akademik është në përputhje me këtë akt dhe rekrutimi i tij është transparent.</p> <p>Sipas tabelës Nr. 3 të RVB (fq. 21), rezulton se numri i personelit akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” përbëhet nga 5 pedagogë, të cilët janë pjesë e Departamentit të së Drejtës Private dhe dy pedagogë që janë pjesë e strukturave të tjera të Fakultetit Juridik. Personeli akademik efektiv (për vitin 2016-2017), i cili është i angazhuar në këtë program studimi (Msc), përbën 58 % të stafit (PAE) të angazhuar në raport me numrin total të stafit. Për vitin akademik 2017-2018, semestri i parë, raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 89 % me 11 %. Për vitin akademik 2017-2018, duke përfshirë planifikimin për semestrin e dytë i cili mund të jetë objekt rishikimi, raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 75% me 25%.</p> <p>Sipas dokumentit “shpërndarja e lëndëve dhe titullarëve”, për vitin akademik 2016-2017, stafi (PAE) ka mbuluar rreth 71.4 % të ngarkesës mësimore në auditor për këtë program studimi (Msc).</p> <p>Grupi i vlerësimit të jashtëm nga të dhënat e aksesuara gjatë vizitës në Institucion, në lidhje me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi për periudhën e vlerësimit (2011-2018) ka analizuar në funksion të këtij raporti të dhënat e mëposhtme (në faqet 11-12 të këtij raporti gjenden të dhëna më të detajuara në lidhje me stafin PAE dhe PAK):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin akademik 2011-2012 raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 82% me 18%. - Për vitin akademik 2012-2013 raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 80% me 20 %. - Për vitin akademik 2013-2014 raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 67% me 33%, ndërsa ngarkesa mësimore që është mbuluar nga PAE/PAK është 82%/18%. - Për vitin akademik 2014-2015 raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 46% me 54%,%, ndërsa ngarkesa mësimore që është mbuluar nga PAE/PAK është 57%/43%. - Për vitin akademik 2015-2016 raporti ndërmjet PAE
---	---

	<p>dhe PAK është 46% me 54%,%, ndërsa ngarkesa mësimore që është mbuluar nga PAE/PAK është 57%/43%.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin akademik 2015-2016 raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 70% me 30%, ndërsa ngarkesa mësimore që është mbuluar nga PAE/PAK është 71.4 %/28.6%. - Për vitin akademik 2017-2018, semestri i parë, raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 89 % me 11 % (8 PAE dhe 1 PAK). Për vitin akademik 2017-2018, duke përfshirë planifikimin për semestrin e dytë i cili mund të jetë objekt rishikimi, raporti ndërmjet PAE dhe PAK është 75% me 25% (9 PAE dhe 3 PAK). <p>Përsa i përket vlerësimit të personelit, Institucioni ndjek një procedurë vlerësimi për personelin akademik i cili përfshin të dhënat që vijnë nga pyetëtori i studentëve; formulari i vlerësimit të stafit, i cili realizohet nga pjesëmarrja e stafit të ngarkuar për ndjekjen e performancës akademike në auditor të pedagogëve, respektimin e orarit mësimor (mbi baza kontrolli të rastësishëm). Të gjitha këto të dhëna bëhen pjesë e një analize vjetore.</p> <p>Institucioni mban një bazë të të dhënave të raporteve të rekrutimit të personelit, si edhe të njoftimeve për punë.</p>
--	--

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit “Master i Shkencave në të Drejtë Private dhe Biznesi” ka titullin shkencor “Profesor i Asociuar”. Titullarët e lëndëve në programin e studimit, për vitin akademik 2016-2017, “Master i Shkencave në të Drejtë Private dhe Biznesi”, janë 2 me titullin “Profesor”, 4 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 4 me gradën “Doktor”. Në programin e studimit Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi”, dy janë me titullin “Profesor” katër janë me titullin “Profesor të asociuar” dhe 4 janë me gradën shkencore “Doktor”, 1 është doktorante, ndërsa 1 anëtar ka përfunduar vetëm studimet master (sipas RVB-së).</p> <p>Për vitin akademik 2016-2017 të gjithë titullarët e lëndëve kanë së paku gradën shkencore “Doktor”. Jo në të gjitha lëndët e kurrikulës së programit Msc, titullarët janë personal PAE. Në katër prej këtyre lëndëve të kurrikulës titullarët janë PAK dhe mbajnë titujt dhe gradën shkencore. Në lidhje me sa më sipër, për vitin akademik 2017-2018 (semestri i parë) në vetëm një prej lëndëve titullari është PAK. Duke përfshirë dhe planifikimin për semestrin e dytë, i cili mund të jetë objekt rishikimi, në katër prej lëndëve titullari është PAK. Drejtuesit e njësive janë të gjithë personel i punësuar me kohë të plotë (PAE).</p> <p>Përsa i përket praktikave profesionale, Institucioni ka një procedurë e cila i siguron vetë studentit mundësinë për të zgjedhur vetë vendin e realizimit të praktikës profesionale. Praktika profesionale nuk zhvillohet në mënyrë të përqendruar në disa institucione, por secili student e zhvillon atë më vetë. Sipas dokumentacionit të administruar gjatë vizitës në institucion rezulton se si pedagog mbikëqyrës është vetëm një. <i>Duke pasur në konsideratë numrin e studentëve si edhe standardet shtetërore, rezulton se ky kriter nuk plotësohet.</i></p>
---	--

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Nga RVB (fq.24-25) dhe nga verifikimi në institucion (intervista me personelin akademik dhe me studentët) rezulton se studentët që në fillim parashtrojnë fushën në të cilën do të realizojnë tezën për marrjen e diplomës. Gjithashtu në çdo rast sigurohet edhe pedagogu udhëheqës. Nga intervista me Rektoren e IAL-së rezulton se me studentët bëhen dhe seanca metodologjike, në lidhje me detyrimet që ato kanë në këtë program studimi, detyrat e kursit që duhet të realizojnë, si edhe tezën që duhet të mbrojnë në fund të studimeve.</p> <p>Referuar të dhënave për personelin akademik që jep mësim në këtë program studimi, rezulton se në shumicën e rasteve pedagogu udhëheqës ka titullin “Profesor i Asociuar”, ndërsa në disa raste edhe gradën “Doktor”.</p> <p>Nga RVB (fq.24) rezulton se asnjë udhëheqës nuk mbikëqyr më shumë se 10 studentë, në këtë program studimi, i cili i përket fushave të shkencave shoqërore dhe humane.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Të gjitha temat janë brenda fushës studimore-kërkimore që ofron programi i studimit.</p> <p>Të gjithë udhëheqësit kanë njohuri të avancuara dhe të thelluara për zhvillim e kërkimit dhe hartimin e tezës për këtë program studimi.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nisur nga natyra e këtij program studimi, rezulton se nga ana e institucionit, është vënë në dispozicion personeli i bibliotekës së Universitetit, sekretaria mësimore si edhe punonjës IT. Po kështu edhe mirëmbajtja e këtyre ambjenteve realizohet nga personeli përkatës.</p> <p>Nga ana e Institucionit rezulton se ka një personel të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës akademik i cili mundëson zhvillim normal të procesit të mësimdhënies si edhe realizimin e shërbimeve në favor të studentëve.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Sipas tabelës Nr. 3 të RVB (fq.21), rezulton se personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi për vitin 2016-2017 përbëhet nga 5 pedagogë të Departamentit të së Drejtës private dhe 2 pedagogë nga struktura të tjera të Fakultetit Juridik, të cilët përbëjnë 58 % të stafit të angazhuar dhe sipas dokumentit “shpërndarja e lëndëve dhe titullarëve”, për vitin akademik 2016-2017, PAE, ka mbuluar, për profilin “E Drejtë Biznesi”, ngarkesën në masën 75% të orëve mësimore, ndërsa për prfilin “E Drejtë Private”, ngarkesën në masën 67% të orëve mësimore.</p> <p>Për të dy profilet, ngarkesa nga PAE mbulohet në masën 71 %.</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018 (Sem I), sipas dokumentit “Shpërndarja e lëndëve dhe titullarëve”, rezulton se PAE, ka mbuluar, për profilin “E Drejtë Biznesi”, ngarkesën në masën 100% të orëve mësimore, ndërsa për profilin “E Drejtë Private”, në masën 85% të orëve mësimore. Për të dy profilet, ngarkesa nga PAE mbulohet në masën 87.5 %.</p> <p>Duke marrë parasysh dhe planifikimin për semestrin e dytë, i cili mund të jetë objekt rishikimi, rezulton se PAE, mbulon, për profilin “E Drejtë Biznesi”, ngarkesën në masën 75 % të orëve mësimore, ndërsa për profilin “E Drejtë Private”, në masën 67 % të orëve mësimore. Për të dy profilet, ngarkesa</p>

	<p>nga PAE mbulohet në masën 71 %.</p> <p>Nga RVB-ja, të dhënat e administruara si edhe verifikimi në institucion rezultojnë se ngarkesa mësimore është e vlerësuar me orë mësimore. Siç rezultojnë nga pjesa përshkruese por edhe ajo tabelare, për vitin akademik 2016-2017, PAE e angazhuar në këtë program studimi ka realizuar 334 orë mësimore në programin Bachelor, 52.5 orë mësimore në programin master që mbulohet nga Departamenti i së Drejtës Publike dhe 551.25 orë mësimore në programin e studimit Msc. në të "Drejtë Private dhe Biznesi". Për vitin akademik 2017-2018, semestri i parë, PAE të angazhuar në këtë program studimi ka realizuar 266 orë mësimore në programin Bachelor, 52.5 orë mësimore në programin master që mbulohet nga Departamenti i së Drejtës Publike dhe 367.5 orë mësimore në programin e studimit Msc. në të "Drejtë Private dhe Biznesi".</p> <p>Lidhur me ngarkesën e përgjithshme të stafit në orë në auditor dhe lëndë, për vitin akademik 16-17, stafi PAE paraqitet: 1 pedagog ka mbuluar 1 lëndë, 1 pedagog ka mbuluar 2 lëndë, 3 pedagogë kanë mbuluar 3 lëndë dhe 2 pedagogë 4 lëndë. Ngarkesa në orë në auditor paraqitet nga 26.5 deri në 179 orë. Stafi PAK paraqitet: 4 pedagogë kanë mbuluar 1 lëndë dhe 1 pedagog ka mbuluar 3 lëndë. Ngarkesa në orë në auditor paraqitet nga 37.5 deri në 157.25. Për vitin akademik 17-18, semestri i parë, stafi PAE paraqitet: 1 pedagog mbulon 1 lëndë dhe 7 pedagogë mbulojnë 2 lëndë. Ngarkesa në orë në auditor paraqitet nga 30 deri në 157.5 orë në auditor. Stafi PAK paraqitet: pedagogu i vetëm PAK i angazhuar në semestrin e parë mbulon 1 lëndë dhe ka ngarkesë 94.5 orë në auditor.</p>
--	---

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Nga kontrolli në Njësinë e Burimeve, rezultoi se të gjithë anëtarët e personelit akademik kishin dosjen e tyre personale në të cilën gjendeshin Dokumenti i identitetit, Dokumenti që vërteton punën e kryer më parë, Librezat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, Diploma Universitare dhe lista e notave, Diploma dhe dokumente të tjera të gradave dhe titujve shkencorë, si dhe të kualifikimeve të tjera, Librezat shëndetësore, Adresa e vendbanimit, Lista e botimeve, artikujve dhe kërkimeve shkencore.</p> <p>Nga RVB si edhe nga verifikimi në institucion, në departament dhe në njësinë e burimeve njerëzore rezultojnë se Fakulteti dhe njësitë bazë disponojnë listën e plotë të personelit akademik.</p> <p>Nga verifikimi i praktikave të punësimit në Institucion, rezultojnë ky Institucion i publikon kriteret e punësimit të personelit akademik.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka një personel të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës akademik i cili mundëson zhvillim normal të procesit të mësimdhënies si edhe realizimin e shërbimeve në favor të studentëve. Angazhimi i personelit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, si edhe me vizionin dhe misionin që ka UET.
2. Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc. "E Drejtë Private dhe Biznesi" për vitet akademike 2011-2018 ka ndryshuar në numër dhe në angazhimin në realizimin e programit mësimor. Nga analiza e të dhënave që gjenden në RVB dhe nga dokumentacioni që GVJ mori gjatë vizitës në institucion, rezultojnë që ngarkesa mësimore ndërmjet PAE dhe PAK për vitin akademik 2014-2015, nuk është në parametrat që kërkohen për standardin II.1 Kriteri 2, ndërsa për vitet e tjera është brenda standardeve.
3. Në programin e studimit Master i Shkencave "E Drejtë Private dhe Biznesi", aktualisht, janë të angazhuar pedagogë që mbajnë grada shkencore dhe tituj akademik të përshtatshëm për zhvillimin dhe funksionimin akademik të tij.

4. Titullarët e lëndëve nuk janë të gjithë personel akademik efektivë edhe pse angazhimi i personelit akademik me kontratë në rolin e titullarëve të lëndëve përbëhet nga pedagogë që mbajnë tituj dhe grada shkencore.
5. Vetëm një pedagog është angazhuar për mbikqyrjen e praktikave profesionale. Në raport me numrin e studentëve në këtë program studimi, angazhimi i vetëm një pedagogu nuk është në përputhje me standardet shtetërore.

Standardet plotësohen krvesisht.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Universiteti European i Tiranës ka në dispozicion tre godina: Godina A është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000 m²; Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000 m²; Godina C (biblioteka) gjithsej 300 m². Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit së bashku me ambientet e tjera në funksion të jetës akademike është rreth 10,000 m².

Këto sipërfaqe janë të ndara në salla leksionesh, salla seminaresh, salla laboratoresh, salla internet, biblioteka, salla për departamentet, drejtuesit e institucionit, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit Msc në “E Drejtë Private dhe Biznesi” janë ato ku zhvillohet procesi mësimor dhe akademik dhe për programet e tjera të studimeve në këtë institucion. Ambientet ku Institucioni zhvillon veprimtarinë e tij janë si më poshte (të dhënat janë nga RVB-ja):

- Salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1510 m² dhe 1515 vende.
- Salla seminari janë gjithsej 14, me sipërfaqe 45 m² dhe secila me nga 35 karrige.
- Salla 70 vendëshe (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100 m² secila.
- Salla për departamentet janë gjithsej 8 ambjente me sipërfaqe 45 m² secila.
- Zyra për përgjegjës departamenti janë gjithsej 8 ambjente me nga 18 m².
- Zyra për kordinatore janë gjithsej 6 ambjente me nga 14 m².
- Salla për laborator informatike janë 3 salla me sipërfaqe 45 m² secila me kapacitet 35 vende.
- Sallë interneti me sipërfaqe 165 m² me 80 kompjutera.
- Zyra për pedagogët janë 30 me sipërfaqe 14m² secila dhe një sallë e madhe me sipërfaqe 150 m², me 32 poste pune.
- Salla për bibliotekën ka sipërfaqe 300 m², 150 vende leximi.
- Mjedisi për fotokopje dhe librari ka sipërfaqe 150 m².
- Zyra informacioni për studentët janë 2.
- Korridore plus holle janë gjithsej 8 me 150 m² secili.
- Mjedisi çlodhes për kafe/fast-food/etj është në një sipërfaqe të vetme 500 m².
- Nyje hidrosanitare janë gjithsej 48 me sipërfaqe 300 m².
- Zyra për dekanin/zv.dekanin/kancelarin janë 5 me nga 20 m².
- Zyra për sekretarinë mesimore janë 3 me sipërfaqe 140 m².
- Zyra për stafin akademik dhe administrativ janë 12 me sipërfaqe 350 m².
- Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore janë 3 me sipërfaqe 140 m².

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në ditën e dytë të vizitës së tij në institucion (datë 08.02.2017), vëzhgoi nga afër sallat e leksioneve, të seminareve, bibliotekën (së bashku me numrin e kompjuterave në këtë ambient), sallën e informatikës dhe labororet (në përdorim ishin 4 laboratorë mësimorë informatike, përkatësisht Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor; Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit) dhe 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare), sekretarinë mesimore, zyrën e IT-së dhe zyrat e anëtarëve të departamentit si dhe të drejtuesit të institucionit. Të dhënat e raportuara përputhen me ato të deklaruara. (shih tabelat 5/1 dhe 5/2)

Biblioteka është ngritur në nivel IAL dhe shfrytëzon një ambient të vetëm. Në të ndodhen ambjente leximi si edhe ambjente për përdorimin e kompjuterave. Pasurimi i bibliotekës bëhet sipas kërkesave që paraqiten nga çdo njësi bazë e IAL-së dhe shfrytëzohet mundësia e blerjes së tyre gjatë zhvillimit të panairit kombëtar të librit, si rregull në muajin nëntor të çdo viti. Gjatë vizitës në Institucion u administrua një praktikë e pasurimit të bibliotekës, në të cilën përfshihet kërkesa për abonim në revista periodike si edhe porosi për tekste studimore. Në këtë praktikë janë gjithashtu edhe pagesat përkatëse dhe blerjet që janë bërë në rrugë elektronike. Një tjetër aspekt pozitiv është që nga ana e IAL bëhen dhe përkthime të teksteve të huaja në gjuhën shqipe dhe të cilat bëhen pjesë e fondit të bibliotekës. Biblioteka shërben nëpërmjet literaturës fizike dhe asaj elektronike. Kështu nga ana e IAL janë lidhur marrëveshje që bëjnë të mundur

aksesimin në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia. Këto biblioteka elektronike u aksesuan nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm në institucion dhe rezultuan plotësisht funksionale.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezultoi se IAL-nuk dokumenton literaturën për çdo program studimi por e ka të individualizuar atë mbi bazë fakulteti. Megjithatë gjatë vizitës në institucion, por edhe nga analiza e dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se literatura që mbështet programin e studimit, ajo e deklaruar në kurrikulat e lëndëve, është pjesë e fondit të bibliotekës dhe plotësisht e aksesueshme.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës ka një vendndodhje të përhershme që prej 2007 në Blv. Gjergj Fishta; në vitin 2010 infrastruktura e universitetit është dyfishuar dhe me një godinë tjetër (në përdorim). Institucioni siguron një menaxhim të mirë të të gjitha ambjenteve ku zhvillon aktivitetin e tij.</p> <p>Në funksion të programit Msc. janë në dispozicion ambjentet në fashon orare në të gjitha ditët e javës nga ora 17:00 dhe të shtunave 9:00 – 16:00.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në ambjentet e bibliotekës dhe nga takimi që zhvilloi me drejtuesen e kësaj biblioteke, GVJ u njoh me literaturën e disponueshme për këtë program studimi. Aktualisht biblioteka dispononte: 4734 tituj në shqip dhe 1371 tituj gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht) tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse për të gjitha programet e studimit.</p> <p>Biblioteka ka 150 vende leximi dhe 12 kompjutera për punime dhe kërkime shkencore.</p> <p>Gjithashtu janë kryer abonime në biblioteka virtuale, dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik më së shumti artikuj shkencorë, ku rendisim: Sage, Ebsco dhe Questia.</p> <p>Nga IAL ndiqet një procedurë vjetore e pasurimit të bibliotekës bazuar në kërkesat që bëhen në fillim të çdo viti nga ana e stafit akademik. Gjithashtu IAL-ja përkthen edhe tekste të huaja, si edhe shfrytëzon mundësinë e blerjes së teksteve të reja gjatë zhvillimit të panairit kombëtar të librit, si rregull në muajin nëntor të çdo viti.</p> <p>Gjithashtu gjatë vizitës në institucion u vendos në dispozicion edhe një praktikë e pasurimit të bibliotekës, blerjet e bëra si edhe një listë me literaturën që gjendet në bibliotekë. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezultoi se IAL nuk dokumenton literaturën për çdo program studimi por e ka të individualizuar atë mbi bazë fakulteti. Megjithatë gjatë vizitës në institucion, por edhe analiza e dokumentacionit të paraqitur rezultoi se literatura që mbështet programin e studimit, ajo e deklaruar në kurrikulat e lëndëve, është pjesë e fondit të bibliotekës dhe plotësisht e aksesueshme.</p> <p>Orari i Bibliotekës për programin e ciklit të dytë është më e përshtatshme: nga Hënë-Premte 9:00-17:00.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Nga vëzhgimi që gjatë vizitës në institucion GVJ realizoi, vlerësohen të përshtatshme të gjitha ambientet ku zhvillohet procesi i mësimdhënies.</p> <p>Në sistemin LMS është një informacionin bazë si: regjistrimi i të gjithë studentëve në lëndët e tyre përkatëse; akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin; regjistrimi i të gjitha lëndët që ofrohen në UET; regjistrimi i të gjithë pedagogët përgjegjës për çdo lëndë. Çdo pedagog menaxhonte lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse. Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit për çdo tipologji, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi jepte mundësinë që përpara logimit çdo pedagog apo student të mund të shohë të gjitha lëndët që ofrohen në universitet; Sistemi mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemin nga studentët.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në funksion të programit Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” janë në dispozicion ambiente të përshtatshme akademike si dhe studimore, të cilat mundësojnë realizimin e qëllimit të këtij programi. 2. Përdorimi i sistemit LMS është një instrument strukturor mjaft i mirë akademik, i cili ndihmon studentët dhe stafin në administrimin dhe vlerësimin e punës akademike. Ky sistem informacioni mban të dhëna në lidhje me: regjistrimin e studentëve; literaturën e postuar nga stafi akademik; ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies..etj. 3. Sallat dhe mjediset në të cilat zhvillohej aktiviteti akademik si dhe pajisjet infrastrukturore në dispozicion vlerësohen të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet dhe nevojat e zhvillimit të procesit të mësimdhënies. 4. GVJ vlerëson se pasurimi i bibliotekës kryhet rregullisht, mbi baza vjetore, bazuar në kërkesat e stafit akademik. Gjatë vizitës në institucion por edhe në verifikimin e titujve të përcjellë si dokumentacion rezultoi se biblioteka disponon literaturën e nevojshme që mbështet programin e studimit. <p><u>Standardet plotësohen plotësisht.</u></p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Burimi kryesor i financimi janë tarifatat e shkollimit që vijnë nga pagesa e studentëve në të tre ciklet e studimeve. Një formë tjetër financimi vjen dhe nga aktivitetet tregtare (qeradhënie, parkim, etj.) Gjatë viteve 2013-2016 është edhe kontributi i granteve për kërkim dhe kontratat.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Grantet për kërkim: Për vitin 2013 - 13.118.534; Për vitin 2014- 3.033.080; Për vitin 2015- 7.607.575 ; Për vitin 2016- 19.984.477

Gjatë vizitës në institucion, sidomos intervista me pedagogët, rezultoi se pagesa e tyre përbëhej nga dy komponentë të rëndësishëm. Pjesa e parë e kësaj pagese, e cila është fikse lidhet me zhvillimin normal të aktivitetit mësimor. Gjithashtu stafi akademik, kishte në dispozicion edhe një tjetër pagesë, e cila paguhej në varësi të kërkimit shkencor që realizonte dhe publikimeve që bënte për këtë qëllim. Nga këto të dhëna rezultoi se granti për kërkim shpërndahej tek personeli akademik, në varësi të publikimeve shkencore që ata paraqesnin në strukturat përkatëse të IAL-së.

Tarifatat për dhe gjatë shkollimit: Për vitin 2011 - 606.601.244; Për vitin 2012- 620.141.196; Për vitin 2013- 641.342.827; Për vitin 2014- 645.120.809 ; Për vitin 2015- 679.213.964; Për vitin 2016- 735.953.246

Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj): Për vitin 2011- 5.809.119 ; Për vitin 2012- 303.009; Për vitin 2013- 28.763.199; Për vitin 2014- 39.006.924; Për vitin 2015- 127.723.768; Për vitin 2016- 104.950.864.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje):

2014-2015	3.428 (numri studentëve)	175.980 (kosto për studentët)
-----------	--------------------------	-------------------------------

2015-2016	4.149 (numri studentëve)	165.100	(kosto për studentët)
2016-2017	4.066 (numri studentëve)	182.500	(kosto për studentët)

(shiko tabelat 6/1 dhe 6/2)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Projekti financiar hartohet në muajin korrik të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm i kësaj shoqërie tregtare (sh.p.k) dhe për zbatim e tij ngarkohet Zv. Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë që gjithmonë të ketë një rezervë të të ardhurave, duke mos përfshirë të ardhurat e vitit pasardhës, në mënyrë të tillë që të mbulohen shpenzimet në vazhdimësi për çdo student deri në diplomimin e tij.</p> <p>Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi i pavarur ose audituesi ligjor jep opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kerkuara te kontabilitetit.</p> <p>Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të detajuar aspektet financiare si dhe pozicionin financiar të shoqërisë (Sh.p.k) deri në 31 Dhjetor të çdo viti. Këto pasqyrojnë dhe rezultatin e operacioneve për vitin përmblyës (deri në datën e mësipërme), në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Raporti vjetor i auditimit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat e tjera në funksion të rritjes së kapaciteteve mësmdhënëse dhe kërkimit shkencor si dhe të cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>UET realizon një auditim financiar për çdo vit akademik. Nga ky auditim dalin të dhënat në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve (sipa RVB-së faqa 32).</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. GVJ, duke u bazuar dhe tek të dhënat e pasqyruara në RVB konkludon që menaxhimi i burimeve financiare është konform standardeve të kerkuara dhe qëllimit të veprimtarisë së institucionit. 2. Mbajtja e pasqyrave financiare rrit transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. 3. Realizimi vjetor i auditimeve financiare nxit eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat e tjera në funksion të rritjes së kapaciteteve mësmdhënëse dhe kërkimit shkencor si dhe të cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh. 	
<u>Standardet plotësohen plotësisht.</u>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit (sipas të dhënave në RVB fq.33). Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të UET-it. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit.

Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga njembdhjete anëtarë, përkatësisht: 1. Dr. Fatri Morina, Kryetar Shtator 2016 (Anëtar – Prill 2012); 2. Dr. Nazmi Xhomara, Anëtar FSHS Shtator 2016; 3. PhD Lorena Licenji, Anëtare FSHS Shtator 2016; 4. Dr. Sofjana Veliu, Anëtare FJ Shtator 2016; 5. MSc. Anton Lulgjuraj, Anëtar FJ Nëntor 2016; 6. Dr. Teuta Xhindi, Anëtare FETI Mars 2013; 7. MSc. Krisela Ngjela, Anëtare FETI Shtator 2016; 8. MSc. Xhoana Zeqo, Anëtare (sekretare e KSBC) Dhjetor 2016; 9. Megi Ruka, Anëtare (studente Msc) Shtator 2016; 10. Ageda Shiba Anëtare (studente Ba) Shtator 2016; 11. Prof. Dr. Adriana Gjonaj Anëtare (e jashtme) Shtator 2016 (Tabela 7)

Vlerësimi i brendshëm i Cilësisë është një proces që kryhet nga institucioni, për të gjykuar për përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe përfshin mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve dhe të diplomuarve, intervistimin e pedagogëve dhe të studentëve, dhe vlerëson statusin e institucionit ose/dhe të programit të studimit përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë - ky proces përfundon me hartimin e një Raporti/Relacioni që i përcillet autoriteve drejtuese të tij (Rektor, Zv/Rektor, Dekan, Përgjegjës Departamenti, etj.) si dhe diskutohet në një mbledhje të posaçme për të adresuar problematikat dhe për të ofruar zgjidhje e përmirësuar situatën. Gjithë informacioni lidhur me procesin e vlerësimit të cilësisë na u vu në dispozicion gjatë vizitës në institucion.

Instrumentat e parashikuar nga Rregullorja dhe të përdorur përgjatë programit Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” janë si më poshtë:

I. Hartimi dhe plotësimi i Pyetësorit për Studentët - Pyetësi hartohet nga KSBC dhe plotësohet në mënyrë anonime nga studentët; ai plotësohet në përfundim të çdo semestri, pra 2 herë në vit dhe pëmban jo vetëm pyetje për pedagogët, por edhe për çështje të tjera, që lidhen me leksionet, komunikimin student-pedagog, infrastrukturën mësimore, për të marrë mendime për aspektet kryesore të zhvillimit të performancës dhe cilësisë, etj.

II. Kalendarët semestralë të Kontrollit të Cilësisë - Për të planifikuar punën lidhur me kontrollin e cilësisë, gjatë vizitës në institucion, intervista e realizuar me GVB si edhe me drejtuesin e KSBC, GVJ u informua se KSBC harton kalendarin e kontrollit të brendshëm të cilësisë për programet mësimore për çdo vit akademik. Sipas këtij kalendari, në bashkëpunim edhe me departamentet janë vizituar seminarët dhe leksionet, duke hartuar relacionet përkatëse.

III. Raporti semestral për çdo pedagog - Nga vizita në institucion, gjatë intervistës së realizuar me pedagogët dhe përgjegjës të departamentit, GVJ u informua se në përfundim të semestrit, çdo pedagog përgatit Relacionin për realizimin e programeve të lëndëve ku pasqyrohet përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës (syllabusit).

IV. Intervistat me studentët - Intervistat apo takimet jo formale me studentët, zhvillohen me qëllim që të diskutohet për procesin mësimor në përgjithësi dhe për probleme të veçanta që ata hasin përgjatë procesit mësimor.

V. Caktimi i ekspertëve të jashtëm - gjatë vizitës në Institucion, gjatë intervistës së realizuar me rektorin, përgjegjës të Departamentit dhe drejtuesin e KSBC, u informua se në mënyrë periodike caktohen ekspertë të jashtëm të cilët mbasi verifikojnë gjendjen aktuale japin rekomandimet e tyre për metodologjinë e mësimdhënies, të kontrollit të njohurive, përmirësimin e tyre, përshtatjen e metodave të reja në gërshetim me teknikat/metodat tradicionale, dhe çdo komponent tjetër në funksion të rritjes së cilësisë dhe shkëmbim të praktikave të mira. Ky fakt u provua edhe nëpërmjet shkresës Nr.5 Prot., datë 20.01.2015 që u vendos në dispozicion të GVJ.

VI. Vlerësimi nga Përgjegjësi i Departamentit – Drejtuesi i njësisë bazë në periudha periodike kontrollon vetë personalisht procesin e mësimdhënies së pedagogëve duke plotësuar në këtë rast formularin përkatës. Ajo që u konstatua në këtë drejtim, ishte fakti se ky kontroll bëhet çdo vit akademik por jo për të gjithë pedagogët.

VII. Fokus Grupet – janë grupe në të cilin marrin pjesë pedagogë, studentë ish student dhe përfaqësues të botës së biznesit të cilët japin mendimet e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe të diplomimit të studentëve dhe që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë në këtë institucion.

VIII. Veprimtaria kërkimore shkencore e stafit - është një komponent mjaft i rëndësishëm në funksion të rritjes së cilësisë në procesin e mësim-dhënies/mësim-nxënies. Sipas RVB, rezultoni se Institucioni për shkencat humane ka dedikuar një revistë “POLIS”, revistë e cila ka numrin e saj të dedikuar të ISSN.

Në përfundim të grumbullimit të informacionit nga të gjithë komponentët e mësipërm, KSBC harton një Relacion Përmbledhës, me të gjitha të dhënat, gjetjet, problematikat dhe sugjerime për përmirësim, i paraqitet autoriteteve drejtuese që i diskutojnë në një mbledhje të posaçme, dhe rekomandimet apo planin e punës për përmirësimet e nevojshme dhe rritjen e cilësisë ua parashitë pedagogëve në fillim të semestrit/vitit akademik të ri.

Nga vizita në institucion si dhe konsultimi i dokumentacionit të kërkuar lidhur me të dhënat sasiore për vlerësimin e cilësisë, rezultoi përputhshmëri e plotë e të dhënave të reflektuara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuarat me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Institucioni përdor kryesisht metodat e vlerësimit sasior dhe cilësor në vlerësimin e ecurisë së programit studimor Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi”; sasior lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga pedagogët dhe studentët dhe cilësor pasi analizon proceset e mësim-dhënies/mësim-nxënies, analizon praktikat e ndjekura në vlerësim, përmirëson komunikimin student-pedagog, etj.</p> <p>Institucioni e ka përfshirë të gjithë këtë informacion në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe kjo reflektohet në RVB, (fq.34-37)</p> <p>Institucioni të gjithë informacionin e përdor me qëllim rritjen e cilësisë së tij. Madje këtë informacion institucioni për transparencë dhe e publikon.</p> <p>Institucioni për të matur dhe vlerësuar cilësinë, përdor kryesisht metoda dhe teknika të tërthorta të marrjes së informacionit (siç reflektohet te pjesa përshkruese më sipër) kryesisht pyetësorë të studentëve dhe pedagogëve, takime ndërmjet tyre, intervista, etj.</p> <p>Këto vlerësime plotësohen edhe nga marrja e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë kryesisht nga vizitat në leksione dhe seminare, ndjekja e praktikave mësimore, vlerësimet paraprake të pjeshme në kolekiume, detyrat e kursit, gjyqe të simuluar (imituese) etj.</p> <p>Në përfundim të të gjithë këtyre komponentëve të vlerësimit të cilësisë, hartohet një Raport/Relacion i cili i vihet në dispozicion autoriteteve drejtuese dhe diskutohet.</p>
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Nga kontrolli, që realizoi vetë GVJ, rezulton se institucioni publikon në faqen e vetë të internetit raportet e vlerësimit të brendshëm të realizuar nga vetë institucioni.</p>
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të</p>	<p>Institucioni gjetjet e KSBC i bën diskutime në nivel Fakulteti dhe Departamenti. Në këto nivele diskutohet me tej për dobesitë e konstatuara dhe për ecurinë e</p>

<p>dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>programeve, si edhe për përmirësimin e tyre.</p> <p>Konkluzionet e arritura nga strukturat e Institucionit mbasi diskutohet edhe me fokus grupet si edhe me Bordin e Tregut të Punës, pasohen në hartimin e politikave që kanë si qëllim përmirësimin e programit të studimit.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar me një kohëzgjatje prej 5 vitesh akademike në nivel institucional me VBA Nr.12, datë 07.04.2017, deri më datë 06.04.2022.</p> <p>Institucioni përdor të gjitha instrumentet e përshtatshme për sigurimin e cilësisë në mësim-dhënie dhe mësim-nxënie, të cilat monitorohen në zbatimin e tyre nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (siç reflektohet te pjesa përshkruese sipër).</p> <p>Institucioni i ka kushtuar rëndësi edhe kërkimit shkencor duke krijuar kushte për botime në revistën 'POLIS' e cila është pajisur me numër ISSN, ka Bordin e saj Shkencor dhe botohet periodikisht. Vihet re që botimet në revistë janë kryesisht të stafit akademik të gjithë Universitetit. <i>GVJ rekomandon që Bordi Shkencor të caktojë herë pas here tema apo problematika ligjore që të mund të trajtohen jo vetëm nga stafi akademik i Fakultetit por edhe nga ekspertë të fushës, për të nxitur dhe rritur cilësinë e debatit juridik.</i></p> <p>Institucioni ka një politikë të qartë lidhur me efikasitetin e veprimtarive që kryen dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë të programit të studimit “Master i Shkencave në të Drejtë Private dhe Biznesi”. Ai ndjek procedurën e vlerësimit periodik nëpërmjet pyetësorëve (për studentët dhe pedagogët), kontrolleve periodike të paracaktuara ndaj pedagogëve përgjatë leksioneve dhe seminareve, si dhe nëpërmjet analizës/relacionit individual që çdo pedagog harton në përfundim të modulit që zhvillon (siç reflektohet te pjesa përshkruese sipër).</p> <p>Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme (periodik) të programit të studimit Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi” – kjo realizohet nëpërmjet pyetësorëve, relacioneve, monitorimeve, kontrolleve, intervistave, takimeve, etj, (siç reflektohet te pjesa përshkruese më sipër).</p> <p>Institucioni ka qëllim dhe praktikë pune ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programin e studimit Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi” lidhur me sigurimin e cilësisë. Kjo proklamohet edhe në misionin e institucionit. Institucioni ka marrë të gjitha masat formale dhe konkrete për matjen e cilësisë dhe përmirësimin e saj.</p> <p>Institucioni ka hartuar edhe një set dokumentacioni informues dhe edukues që në fillim të programit, i cili u shpërndahet studentëve duke patur në vëmendje informimin në lidhje me programin e studimit. Institucioni realizon fushata reklamuese në IAL të tjera me qëllim tërheqjen e studentëve për ndjekjen e këtij programi studimi.</p>

Nga verifikimi në faqen e internetit të institucionit rezulton se nga ana e tij është hartuar Plani Strategjik i zhvillimit të institucionit. Ndërkohë që çdo vit akademik hartohet edhe plani i punës së KSBC me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Këto akte dhe informacione ende nuk reflektohen në faqen e internetit të institucionit. *GVJ rekomandon një transparencë më të madhe në lidhje me të gjitha proceset e brendshme të zhvillimit të institucionit.*

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni, në programin e studimit Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi”, përdor metodat e vlerësimit sasior dhe cilësor lidhur me vlerësimin e ecurisë së programit. Metoda sasiore lidhet me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga anketimet/pyetësorët e studentëve, ndërsa metoda cilësore lidhet me analizën e procesit të mësimdhënies/mësimnxënies.
2. Në përputhje me verifikimet e realizuar nga vetë GVJ rezultojnë se Institucioni publikon në faqen e tij të internetit në mënyrë periodike raportet e vlerësimit të brendshëm që ka realizuar vetë ai.
3. Strukturat e departamentit kanë hartuar edhe një set dokumentacioni informues në lidhje me këtë program studimi, i cili u shpërndahet studentëve duke patur në vëmendje informimin në lidhje me numrin e krediteve, lëndët dhe modulet e kurrikulës, titullarët e lëndëve dhe literaturën që do të përdoret në secilin prej lëndëve të programit.
4. Institucioni i ka kushtuar rëndësi edhe kërkimit shkencor duke krijuar mundësinë e publikimit të artikujve shkencor të stafit akademik në revistën shkencore periodike 'POLIS' e cila është pajisur me numër ISSN.
5. GVJ rekomandon që Bordi Shkencor të caktojë herë pas here tema apo problematika ligjore që të mund të trajtohen jo vetëm nga stafi akademik i Fakultetit por edhe nga ekspertë të fushës, për të nxitur dhe rritur cilësinë e debatit juridik.
6. GVJ rekomandon një transparencë më të madhe në lidhje me të gjitha proceset e brendshme të zhvillimit të institucionit.

Standardet plotësohen plotësisht.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” ka në misionin e tij formimin profesional të studentëve në të drejtën private dhe në të drejtën e biznesit në varësi të profilit të zgjedhur nga studentët. Programi Msc është i organizuar në dy vite mësimore që përbëhen nga katër semestra. Programi mësimor realizohet me orët mësimore në auditor (në formën e leksioneve dhe seminareve në raportet 2/1) si dhe në orët jashtë auditorit (raporti orë në auditor me jashtë auditorit është në raportin: leksionet 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit, seminarët 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit. Literatura dhe materiale të tjera të detyrueshme, mbështetëse dhe ndihmëse janë në shqip dhe kryesisht në anglisht. Ka dhe disa botime që janë të UET Press.

Në këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” janë gjithsej 14 (katërmëdhjetë) lëndë/module dhe ato përbëhen nga lëndë të formimit të përgjithshëm (12 ECTS), lëndë të formimit karakterizues të programit (42 ECTS), lëndë për secilin profil (bazuar në profilin e zgjedhur nga studenti - 12 ECTS), lëndë në disiplinën me zgjedhje (6 ECTS), praktikën profesionale (12 ECTS) dhe tezën e diplomës (36 ECTS).

Në këtë program studimi ndiqej dhe procedurat e transferimit të studimeve nga IAL-të brenda apo jashtë vendit (ekuivalentimi i krediteve të fituara). GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u njoh me disa nga dosjet e transferimeve të studentëve nga një nga universitetet brenda vendit dhe konstatoi se komisioni përkatës bënte njohje të lëndëve sipas krediteve të fituara nga universiteti i mëparshëm dhe jo në bazë të krediteve që lënda përkatëse kishte në kurrikulën e programit. Kjo çonte në një numër më të madh kreditesh që studenti mund të kishte në fund të studimeve. GVJ, për sa më sipër, në takimin përmblyllës të vizitës, bëri një përshkrim/raportim të asaj që kishte konstatuar dhe tek drejtuesi i institucionit (Rektori).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Programi i studimit Master i shkencave në “E Drejtë Private dhe Biznesi” ofrohet me dy profile: i) E Drejtë Private dhe ii) E Drejtë Biznesi. Numri i lëndëve që përbëjnë këtë program studimi është 14 (katërmëdhjetë). Lëndët ndahen në: 2 lëndë të formimit të përgjithshëm, 7 lëndë të formimit karakterizues të programit, 2 lëndë për secilin profil (bazuar në profilin e

zgjedhur nga studenti), 1 lëndë formuese e zgjedhur. Praktika Profesionale (12 ECTS) dhe Punimin i diplomës (36 ECTS) është pjesë e kurrikulës.

Plani mësimor i programit të studimit Master i shkencave në “E Drejtë Private dhe Biznesi” është i ndërtuar me grupin e lëndëve të detyrueshme – 4 lëndë për çdo semester dhe në semestrin e katërt realizohet lënda “E Drejtë Bankare” si edhe praktika profesionale bashkë me Tezën/punimin e diplomës.

Në planin mësimor të programit të studimit Master i shkencave në “E Drejtë Private dhe Biznesi” janë ofruar dhe grupet e lëndëve më zgjedhje, në semestrin e parë ose të dytë.

Procedura për zgjedhjen dhe miratimin e temës së diplomës nis që në semestrin e parë të vitit të dytë, në mënyrë që studentit të ketë kohën e mjaftueshme për të bërë punë kërkimore.

Programi i studimit Msc në “E Drejtë Private dhe Biznesi” përmban: a) objektivat e programit; b) organizimin e tij sipas viteve/semestrave; c) përcaktimin e lëndëve/moduleve për çdo semestër e shprehur sipas sistemit ETCS (kurrikula); d) çdo plan-program lënde.

Në plan-programin e çdo lënde është i përcaktuar numri i krediteve sipas sistemit ECTS/ orë mësimore në auditor të ndarë në orë leksioni, seminari dhe në disa lëndë në orë pune praktike.

1 (një) vit akademik ka – 28 javë në auditor; -2 (dy) semestra;

1 (një) semestër ka – 14 javë në auditor;

1 (një) ECTS ka - 25 orë mësimore pune të studentit;

25 orët mësimore janë ndarë në – 11/7 orë në auditor dhe 14/18 orë jashtë auditorit. Leksionet 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit. Seminaret 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit.

Në planin e studimit jepet ndarja e krediteve (ECTS) sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (sipas RVB-së në faqet 39 dhe 46):

• Për leksionet	336 orë në auditor dhe 414 orë punë e pavarur e studentit
• Për Seminaret	168 orë në auditor dhe 432 orë punë e pavarur e studentit
• Për projekte/detyra	216 orë në auditor dhe 234 orë punë e pavarur e studentit
• Për Praktikën Profesionale	255 orë në institucion dhe 45 orë punë e pavarur
• Punimi i Diplomës	40 orë pune në auditor dhe 860 orë punë e pavarur e studentit

Forma e kontrollit të njohurive përbëhet nga : 10 % ndjekja e lëndës aktive në auditor; 20 % është pesha e detyrave të kursit; 30% provimi i ndërmjetëm; 40 % është pesha e provimit përfundimtar.

GVJ konstatoi ndryshime në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara. Edhe pas diskutimit për këtë çështje, gjatë vizitës në Institucion, nuk u vu në dispozicion ndonjë material ku të dëshmohej se si është realizuar ky ndryshim. Në dispozicion u vu një procedurë ndryshimi e realizuar, por nuk përmendet programi objekt shqyrtimi.

Këto ndryshime janë:

Lënda: Procedurë civile e krahasuar ishte lëndë vetëm për profilin “E drejtë Private”. Kjo lëndë kaloi në kategorinë B të lëndëve të programit, për studentët e të dy profileve. Në profil u zëvendësua me lëndën Pasuritë e paluajtshme.

Lënda: Debate Bashkëkohore (ishte) lëndë e kategorisë B. Lënda dhe është zëvendësuar me lëndën “Studime të avancuara në të drejtën private”.

Lënda: “E drejta bankare” ishte lëndë vetëm për profilin “E drejtë biznesi”. Lënda dhe ka kaluar në kategorinë B për të gjithë studentët; në profil u zëvendësua me lëndën “E drejta e Konkurrencës”.

▪ ***Të dhënat përkatëse gjenden dhe në tabelat 8/1 dhe 8/2 bashkëngjitur këtij raport.***

Çdo modul/lëndë përmban: titullin e lëndës; titullarin/grupin e pedagogëve; numrin e krediteve; kohën e realizimit të modulit; llojin e lëndës (lëndë formimi bazë apo formimi karakterizues); përshkrimin e lëndës; aftësimin e studentëve përgjatë zhvillimit të lëndës; temat që do të zhvillohen dhe numrin përkatës të orëve; temat për orët praktike dhe numrin e orëve; metodologjinë e mësimdhënies; detyrimet e studentit; formën e vlerësimit dhe komponentët përbërës të vlerësimit; literaturën e detyrueshme dhe plotësuese.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës gjenden në Tabelën 9 të këtij raport.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon të analizojë përveç programeve të lëndëve të dorëzuara nga Institucioni përpara vizitës (për të cilët është shprehur më sipër) edhe programet e lëndëve për vitin akademik aktual. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në Institucion kërkoi të njihet me programet përkatëse të lëndëve për vitin aktual (2017-2018). Nga dokumentacioni që aksesoi GVJ gjen dhe analizon të dhënat e mëposhtme, të cilat i referohen vetëm programeve të lëndëve të zhvilluara gjatë semestrit të parë. Gjatë takimit me Përgjegjësën e Zyrës së Kurrikulave dhe Koordinatorin, GVJ u informua se syllabuset për semestrin e dytë për vitin akademik 2017-2018 nuk ishin ende të miratuara për shkak se ato miratohen para fillimit të çdo semestri. Si rezultat, na u vunë në dispozicion vetëm syllabuset për semestrin e parë.

Vlerësimi për Syllabus-et e lëndëve në disiplinat e formimit të përgjithshëm (për vitin 2017-2018, semestri 1):

1. Emërtimi i lëndës/modulit – ***Metodat e kërkimit në Shkencat Juridike***
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda- Viti i parë/Semestri i parë
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën- Prof. Dr. Adrian Papajani (PAE)
 - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit- e detyrueshme

- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS- 6 ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre- 3 orë mësimore në javë
- Format e vlerësimit të studentëve – 10% diskutimet në seminare; 30% provim i ndërmjetëm; 20 % detyrë kursi; 40% provimi përfundimtar.
- Detyrimet e studentit për lëndën- Frekuentim i detyrueshmë në masën 80%.
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse- literatura e detyrueshme përbëhet nga leksionet e titullarit, një tekst në anglisht dhe një tekst në shqip i përkthyer (UET Press) si dhe nga një numër i konsiderueshëm tekstesh të rekomanduara (të gjitha në anglisht).

Vlerësimi për Syllabus-et e lëndëve në disiplina të formimit karakterizues të programit (për vitin 2017-2018, semestri 1):

1. Emërtimi i lëndës/modulit – *Studime të avancuara në të drejtën private*

- Viti/semestri kur zhvillohet lënda- Viti i parë/Semestri i parë
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën- Prof.Asoc.Dr. Endira Bushati (PAE)
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit- e detyrueshme
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS- 6 ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre- 2 orë mësimore leksion dhe një ore seminar në javë
- Format e vlerësimit të studentëve – 10% diskutimet në seminare; 30% provim i ndërmjetëm; 20 % detyrë kursi; 40% provimi përfundimtar.
- Detyrimet e studentit për lëndën- Frekuentim i detyrueshmë në masën 80%.
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse- literatura e detyrueshme përbëhet nga katër tekste në shqip dhe një tekst i një autori të huaj (në shqip i përkthyer) si dhe nga një kapitull të një teksti në anglisht; tekste dhe akte juridike të rekomanduara.

2. Emërtimi i lëndës/modulit – *E drejta e korporatave*

- Viti/semestri kur zhvillohet lënda- Viti i parë/Semestri i parë
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën- Prof.Asoc.Dr. Edi Spaho (PAE)
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit- e detyrueshme
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS- 6 ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre- 3 orë mësimore në javë në raportit leksion seminar 2/1.
- Format e vlerësimit të studentëve – 10% diskutimet në seminare; 30% provim i ndërmjetëm; 20 % detyrë kursi; 40% provimi përfundimtar.
- Detyrimet e studentit për lëndën- Frekuentim i detyrueshmë në masën 80%.
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse- literatura e detyrueshme përbëhet nga leksionet e titullarit dhe tekste akademike të autorëve vendas si dhe akte ligjore në funksion të lëndës; një numër i konsiderueshëm tekstesh të rekomanduara (kryesisht në anglisht) si dhe akte ndërkombëtare.

3.Emërtimi i lëndës/modulit – *E drejta civile e krahasuar*

- Viti/semestri kur zhvillohet lënda- Viti i parë/Semestri i parë
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën- Prof.Asoc. Dr. Juelda Lamce (PAE)
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit- e detyrueshme
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS- 6 ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre- 3 orë mësimore në javë
- Format e vlerësimit të studentëve – 10% diskutimet në seminare; 30% provim i ndërmjetëm; 20 % detyrë kursi; 40% provimi përfundimtar.
- Detyrimet e studentit për lëndën- Frekuentim i detyrueshmë në masën 80%
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse- literatura e detyrueshme përbëhet nga leksionet e titullares si dhe nga dy tekste në anglisht; ka dhe një numër të konsiderueshëm tekstesh të rekomanduara (kryesisht në anglisht).

4.Emërtimi i lëndës/modulit – *E drejta e pronësisë intelektuale & BE*

- Viti/semestri kur zhvillohet lënda- Viti i dytë /Semestri i parë
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën- Prof.Asoc. Dr. Juelda Lamce (PAE)
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit- e detyrueshme
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS- 6 ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre- 3 orë mësimore në javë
- Format e vlerësimit të studentëve – 10% diskutimet në seminare; 30% provim i ndërmjetëm; 20 % detyrë kursi; 40% provimi përfundimtar.
- Detyrimet e studentit për lëndën- Frekuentim i detyrueshmë në masën 80%
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse- literatura e detyrueshme përbëhet nga një tekst në shqip, një material në anglisht me cases; ka dhe një numër të konsiderueshëm tekstesh të rekomanduara (kryesisht në anglisht).

Vlerësimi për Syllabus-et e lëndëve në disiplina të ngjashme të programit (për vitin 2017-2018, semestri 1):

1. Emërtimi i lëndës/modulit – *Pasuritë e paluajtshme*
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda- Viti i dytë /Semestri i parë
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën- Prof.Dr. Ilir Mustafaj (PAK)
 - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit- e detyrueshme
 - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS- 6 ECTS
 - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre- 2 orë mësimore leksion dhe një ore seminar në javë
 - Format e vlerësimit të studentëve – 10% diskutimet në seminare; 30% provim i ndërmjetëm; 40% provimi përfundimtar.
 - Detyrimet e studentit për lëndën- Frekuentim i detyrueshmë në masën 80%
 - Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse- literatura e detyrueshme përbëhet nga një tekst i titullarit dhe një tekst i një autori tjetër nga UET Press si dhe nga akte ligjore të lidhura me lëndën; tekste dhe akte juridike të rekomanduara.

2. Emërtimi i lëndës/modulit – *E drejta e falimentimit dhe arbitrazhit*
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda- Viti i dytë/Semestri i parë
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën- Phd. Evelina Cela (PAE)
 - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit- e detyrueshme
 - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS- 6 ECTS
 - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre- 2 orë mësimore leksion dhe një ore seminar në javë
 - Format e vlerësimit të studentëve – 10% diskutimet në seminare; 30% provim i ndërmjetëm; 20 % detyrë kursi; 40% provimi përfundimtar.
 - Detyrimet e studentit për lëndën- Frekuentim i detyrueshmë në masën 80%
 - Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse- literatura e detyrueshme përbëhet nga dy botime si dhe nga akte ligjore të lidhura me lëndën; tekste dhe akte juridike të rekomanduara.

Vlerësimi për Syllabus-et e lëndëve në disiplina me zgjedhje të programit (për vitin 2017-2018, semestri 1):

1. Emërtimi i lëndës/modulit – *Studime të avancuara në të drejtën e punës dhe sigurimeve*
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda- Viti i dytë /Semestri i parë
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën- Phd. Renata Kau (PAE)
 - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit- e detyrueshme
 - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS- 6 ECTS
 - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre- 2 orë mësimore leksion dhe një ore seminar në javë
 - Format e vlerësimit të studentëve – 10% diskutimet në seminare; 30% provim i ndërmjetëm; 20 % detyrë kursi; 40% provimi përfundimtar.
 - Detyrimet e studentit për lëndën- Frekuentim i detyrueshmë në masën 80%
 - Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse- literatura e detyrueshme përbëhet nga tekste në shqip; tekste të rekomanduara (kryesisht në anglisht).

Dokumentacioni në lidhje me këto programe lëndësh u aksesua gjatë vizitës së GVJ në institucion.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjehet një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni ofron programin e studimit “Master i Shkencave në të Drejtë Private dhe Biznesi”, akredituar me Urdhër të MAS nr. 68 Dt. 14.02.2011, program i cili është i ndarë në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Sipas dokumentit “Shpërndarja e lëndëve”, rezulton se viti i parë akademik ka në total lëndë të barabarta me 48 kredite dhe viti i dytë akademik ka në total lëndë të barabarta me 72 kredite. Nuk ka një shpërndarje të barabartë të peshës së krediteve ndër vite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë “Master i Shkencave në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, ofron dije me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si edhe trajnim për kërkimin shkencor, duke i aftësuar studentët në drejtim të hulumtimit shkencor, karrierës akademike si edhe përshtatjen në tregun e punës. Ky program studimi ndahet në dy profile, në atë të së drejtës private dhe në atë të së drejtës së biznesit. Diferenca midis këtyre dy profileve qëndron në grupin e lëndëve që ofrohen në kategorinë C (disiplina të ngjashme dhe/ose integruese). Në profilin “E drejtë private” ofrohen dy lëndë që lidhen me të drejtën private të pronësisë dhe të drejtën e veprimtarisë ekonomike (“Pasuritë e paluajtshme” dhe “Çështje të së drejtës ekonomike”), ndërsa në profilin “E drejtë Biznesi” ofrohen dy lëndë po në të njëjtën kategori grup lëndësh (kategoria C) të fokusuar në të drejtën e konkurrencës, falimentit dhe arbitrazhit si fusha të lidhura ngushtë me çështjet e biznesit (“E Drejtë e konkurrencës” dhe “E Drejtë e falimentit dhe arbitrazhit”).</p> <p>Ky program studimi në përgjithësi synon zgjerimin e njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve. <i>Nga takimi i realizuar me studentët gjatë vizitës në institucion, rezultoi se lënda “Metodat e Kërkimit Shkencor”, ishte një përsëritje e njohurive të marra në ciklin e parë të studimeve. GVJ e gjen me vend ta evidentojë këtë fakt meqenëse gjykimi i studentëve ka peshën e tij në vlerësimin e përmbajtjes së lëndëve.</i> Për sa me sipër GVJ u njoh gjatë vizitës me programet e lëndëve që janë aktualisht duke u zhvilluar, në semestrin e parë. Një analizë më e detajuar në lidhje me plan-programet e lëndëve gjendet tek faqet 26-28 të këtij raporti.</p> <p>Ky program studimi i pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike dhe i mundëson ata që të arrijnë të zhvillojnë edhe studimet e ciklit të tretë, atë të doktoraturës.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja dhe organizimi i programit të studimit Msc “E Drejta Private dhe Biznesit” është në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve. Ky program studimi është i ndërtuar mbi bazën njohurive të fituara në ciklin e parë të studimit të fushës përkatëse dhe thellon më tej njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me objektivat e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore (rregullorja mësimore e programeve të ciklit të dytë).</p> <p>Vlerësimi i studentëve realizohet në mënyrë të vazhdueshme për gjatë semestrit ku lëndët përkatëse zhvillohen. Komponentët për gjatë semestrit përbëhen nga: ndjekja dhe aktivizimi në auditor (10%), detyrat e kursit (20%) dhe provimi i ndërmjetëm (30%). Kjo mënyrë e kontrollit dhe vlerësimit për gjatë semestrit jep mundësinë e plotësimit të njohurive dhe qartësime të nevojshme në një mënyrë periodike.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensionet ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit Msc “E Drejta Private dhe Biznesit” është hartuar duke u referuar tek përvojat më të mira bashkëkohore akademike dhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës në lidhje me njohuritë e thelluara në fushën tregtare dhe në atë private në një aspekt më të gjerë.</p> <p>Programi i studimit Msc “E Drejta Private dhe Biznesit” përmban të gjithë elementët e nevojshëm për të qënë ndërkombëtarisht konkurrues.</p>

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Nisur nga mënyra se si është organizuar programi i studimit rezulton se lëndët e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve dhe i pajis studentët me dijet e nevojshme duke i aftësuar ata profesionalisht si edhe për hulumtim shkencor.</p> <p>Ky program studimi është në përputhje me profilin e UET dhe me strategjinë e tij.</p> <p>Gjithashtu rezulton se personeli akademik është i aktivizuar në punë kërkimore-shkencore që ka si qëllim realizimin e programeve të studimit, në funksion të arritjes së qëllimeve për të cilat funksionon ky program studimi.</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	Nuk aplikohet
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimit është hartuar bazuar në disa informacione dhe konsultime që institucioni ka arritur të sigurojë në kuadër të Bordeve të Punës që ka krijuar. <i>Vlerësimi mbi nevojat e tregut të punës nuk është realizuar mbi bazën e një studimi të tregut në këtë fushë.</i></p> <p><i>Duke qenë se GVJ konkludon se nuk ka një studim tregu të mirëfilltë dhe për rrjedhojë dhe vlerësimi mbi nevojat e tregut të punës është për aq sa institucioni vlerëson që është e nevojshme.</i></p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i Studimit Master i Shkencave “E Drejtë Private dhe Biznesi”, nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe ndihmon në ruajtjen e këtyre vlerave. Ky program studimi synon të përfshijë të gjithë materialin akademik që ofrohet në këtë fushë studimi.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezhën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Ky program studimi realizohet në 120 kredite me një kohëzgjatje mesatare 2 vite akademike. Për praktikën mësimore janë përcaktuar 12 kredite, ndërsa për tezhën përfundimtare janë 36 kredite.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	Nuk aplikohet
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	Nuk aplikohet
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	

<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Institucioni ka publikur në faqen e tij të internetit informacion në lidhje me programet e studimit si edhe ka përgatitur një broshurë të plotë në lidhje me to. Modulet dhe syllabuset që janë pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi ofrohen për studentët në formën e shkruar dhe ato janë elektronike dhe në programin LMS ku studentët kanë akses.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Informacioni i dhënë shpjegon të gjithë mënyrën e zhvillimit të programet të studimit, lëndët që duhet të jepen, si edhe mënyrën e diplomimit bashkë me afatet përkatëse.</p> <p>Për praktikën mësimore janë përcaktuar 12 kredite, ndërsa për tezën përfundimtare janë 36 kredite.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ky program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” rezulton të ofrojë lëndë të formimit profesional në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve, duke mundësuar pajisjen e studentëve me dijet e nevojshme edhe për një hulumtim të mëtejshëm shkencor. 2. Për këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” janë përdorur informacione nga konsultimet që institucioni ka arritur të realizojë me Bordet e punës, në lidhje me nevojshmërinë e tregut të punës për të diplomuar në këtë fushë studimi. 3. Vlerësimi i studentëve realizohet në mënyrë të vazhdueshme për gjatë gjithë semestrit sipas komponentëve: ndjekja dhe aktivizimi në auditor (10%), detyrat e kursit (20%), provimi i ndërmjetëm (30%) dhe provimi përfundimtar 40%. Kjo mënyrë e kontrollit dhe vlerësimit për gjatë semestrit jep mundësinë e plotësisht të njohurive dhe nxitjes së procesit të mësimnxënies në mënyrë periodike. 4. Pësia e krediteve në dy vitet akademike nuk është shpërndarë në mënyrë të barabartë. 5. Praktika profesionale nuk zhvillohet mbi bazën e marrëveshjeve institucionale. 6. Institucioni nuk ka realizuar një studim të plotë për nevojat e tregut të punës në fushën përkatëse të studimit. <p>Standardet plotësohen kryesisht.</p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Në bazë të “Rregullores së programit të studimit Msc në “E Drejtë Private dhe Biznesi”, forma e organizimit të mësimdhënies dhe nxënies për të gjitha lëndët realizohet nëpërmjet leksioneve dhe seminareve që zhvillohen në auditor. Puna mësimore zhvillohet në bazë grupi (jo më shumë se 20 studentë). Shkalla e përvetësimit të dijeve vlerësohet me sistemin 10 notësh (ku si kaluese vlerësohet nota “pesë” e lartë). Studenti lejohet të futet në provim kur ka shlyer të gjitha detyrimet që lidhen me lëndën, si edhe detyrimet financiare përkatëse dhe proces verbal i shlyerjes së detyrimeve plotësohet nga pedagogu/ët e lëndës dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore. Rezulton se nëse një student realizonte më shumë se tre mungesa, atëherë ai nuk kualifikohej. Proces-verbali i provimit firmoset nga anëtarët e komisionit të marrjes në provim.

Si pjesë e lëndëve të Kategorisë C: Disiplina të ngjashme dhe/ose integruese dhe kategorisë D: Disiplina të zgjedhura, ofrohen lëndët/kurset e ashtuquajtura “Honors course”. Këto kurse propozohen dhe drejtohen nga pedagogë me grada dhe tituj të Universitetit. Cikle të caktuara leksionesh të tyre mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze. Për cikle leksionesh/module brenda lëndëve të kategorive A dhe B, mund të ftohen edhe ekspertë, profesorë të shquar të fushës.

Megjithatë nga informacioni i marrë në institucion, nga intervista me drejtuesit e departamentit, me pedagogët si edhe me studentët, rezultoi se “Honors course”, nuk janë funksionale plotësisht dhe studentët nuk kanë informacion të plotë në lidhje me këto lloje kurseesh. Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës kërkoi dhe ju vu në dispozicion një nga programet e lëndëve në lidhje me kurset “Honors course”; ky program lënde është hartuar nga titullari Prof.Dr. Ferit Duka dhe miratuar nga Përgjegjësi i Departamentit Prof.Asoc.Dr. Migena Leskoviku; titulli i lëndës është “Sistemi juridik osman në tokat shqiptare”. Nga të dhënat dhe informacioni gjatë vizitës rezulton të mos jetë zgjedhur as kjo lëndë dhe as ndonjë lëndë tjetër e ofruar në këtë kategori grup lëndësh.

Forma e kontrollit të dijeve përbëhet nga këta komponentë: Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive- 10%; Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)- 20%; Testimet gjatë vitit- 30% dhe; Provimi përfundimtar- 40%.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Procedura e pranimit të studentëve në programin e studimit Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” është e parashikuar në rregulloren mësimore të programit të studimit të ciklit të dytë (pika 2). Sipas kësaj rregulloreje, studentët, për tu pranuar në këtë program studimi, duhet të kenë së paku një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) të fituar në një universitet brenda apo jashtë vendit (të ekuivalentuar). Kur diploma e ciklit të parë është në të njëjtën fushë studimi, studenti regjistrohet pa plotësuar kredite për njohuritë formuese dhe nëse kjo diplomë nuk është në të njëjtën fushë studimi (fushë e ngjashme ose e përafërt), studenti regjistrohet me debi formimi deri në 60 ECTS. Nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore nuk rezultoi të kishte studentë të regjistruar në një fushë të ngjashme apo të përafërt dhe për sa më sipër GVJ nuk u njoh me ndonjë procedurë të zbatuar në këtë rast. Dosjet e aplikimit përmbanin: formularin e interesit; kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të parë shoqëruar me listën e notave; CV; një letër interesi; dy rekomandime; dokumenta të aftësisë në një gjuhë të huaj (nëse disponohej nga aplikuesi në momentin e aplikimit). Procedura e pranimit realizohej nga autoritetet përkatëse.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedura e pranimit është e normuar në pikën 2 të rregullores mësimore të programit të studimit të ciklit të dytë. Aplikimet shqyrtohen nga departamenti përgjegjës dhe miratohen nga dekani i Fakultetit. Koordinatorja e Departamentit komunikon me aplikantët për vënien në dijeni të vendimit përkatës. Lista përfundimtare e studentëve të pranuar shpallet zyrtarisht (jo më vonë se dy javë nga fillimi i vitit akademik).

Në lidhje me cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për tre vitet e fundit, GVJ kërkoi dhe ju vu në dispozicion dokumentacioni përkatës. Në bazë të këtyre të dhënave për notën mesatare në hyrje rezultojnë këto të dhëna:

- për vitin 2015-2016 nga 74 studentë të regjistruar në Msc. “E drejtë Private dhe Biznesi” nota mesatare në hyrje ishte 7.43 (më e larta 9.77 dhe më e ulëta 5.22);
- për vitin 2016-2017 nga 46 studentë të regjistruar në Msc. “E drejtë Private dhe Biznesi” nota mesatare në hyrje ishte 7.1 (më e larta 9.86 dhe më e ulëta 5.44);
- për vitin 2017-2018 nga 36 studentë të regjistruar në Msc. “E drejtë Private dhe Biznesi” nota mesatare në hyrje ishte 7.15 (më e larta 9.6 dhe më e ulëta 5.62).

Në bazë të këtyre të dhënave për notën mesatare në dalje rezultojnë këto të dhëna:

- për vitin 2014-2015 nga 97 studentë të diplomuar në Msc. “E drejtë Private dhe Biznesi” nota mesatare në dalje ishte 7.58 (më e larta 10 dhe më e ulëta 5.4);
- për vitin 2015-2016 nga 54 studentë të diplomuar në Msc. “E drejtë Private dhe Biznesi” nota mesatare në dalje ishte 7.22 (më e larta 9.95 dhe më e ulëta 5.2);
- për vitin 2016-2017 nga 51 studentë të diplomuar në Msc. “E drejtë Private dhe Biznesi” nota mesatare në dalje ishte 7.34 (më e larta 9.65 dhe më e ulëta 5.4).

Studentë të regjistruar në vitin e parë (për herë të parë). Nota Mesatare

<input checked="" type="checkbox"/> Sipas <input checked="" type="checkbox"/> Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Studentë transferuar sipas viteve (b)		Studente te transferuar per Brezat (b)	Totali: (a)+(b)
		Viti I	Viti II		
2011-2012					
E Drejtë Biznesi	45			0	45
E Drejtë Private	61			0	61
E Drejtë Private dhe Biznesi (MSH)					106
2012-2013					
E Drejtë Biznesi	39		1	1	40
E Drejtë Private	47		0	0	47
E Drejtë Private dhe Biznesi (MSH)					87
2013-2014					
E Drejtë Biznesi	28		0	0	28
E Drejtë Private	50		2	2	52
E Drejtë Private dhe Biznesi (MSH)					80

2014-2015					
E Drejtë Biznesi	21		2	2	23
E Drejtë Private	32		4	4	36
E Drejtë Private dhe Biznesi (MSH)					59
2015-2016					
E Drejtë Biznesi	17		2	2	19
E Drejtë Private	51		4	4	55
E Drejtë Private dhe Biznesi (MSH)					74
2016-2017					
E Drejtë Biznesi	18		1	1	19
E Drejtë Private	25		2	2	27
E Drejtë Private dhe Biznesi (MSH)					46
2017-2018					
E Drejtë Biznesi	15		2	2	17
E Drejtë Private	19		0	0	19
E Drejtë Private dhe Biznesi (MSH)					36

Për programin e studimit MSc në "E Drejtë Private dhe Biznesi", në lidhje me numrin total të të diplomuarve dhe numrin total të të punësuarve (në përputhje me diplomën) si dhe me numrin total të të punësuarve (jo në përputhje me diplomën) rezultojnë këto të dhëna (sipas RVB):

- Për vitin akademik 2011-2012: 47 të diplomuar; 8 në përputhje me diplomën; 4 të punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2012-2013: 74 të diplomuar; 22 në përputhje me diplomën; 5 të punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2013-2014: 60 të diplomuar; 14 në përputhje me diplomën; 3 të punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2014-2015: 97 të diplomuar; 20 në përputhje me diplomën; 9 të punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2015-2016: 54 të diplomuar; 18 në përputhje me diplomën; 2 të punësuar jo në përputhje me diplomën;

Për të mbështetur studentët e diplomuar në punësim, UET organizon disa aktivitete si: panairi i punës, i cili jep mundësinë e kontaktimit të drejtpërdrejt me përfaqësuesit e të paktën 52 kompanive të ndryshme në vend; krijimi i Bordit të Punës, të cilat sigurojnë një urë lidhëse midis praktikës profesionale, tregut të punës dhe internshipeve; anëtarët e shoqatës Alumni ftohen të janë pjesë aktive e këtyre bordeve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit</p>	<p>Të gjithë studentët që kanë aplikuar dhe janë pranuar në këtë program studimi kanë përfunduar studimet e ciklit të parë "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite.</p> <p>Pranimi në këtë program studimi bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH"</p> <p>Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të parashikuara në rregulloren përkatëse. Kriteri i gjuhës angleze (por edhe i gjuhëve të tjera të përcaktuara në ligj), është tashmë një kriter hyrës dhe kërkohet domosdoshmërisht nga ana e institucionit. Në këtë drejtim duhet përditësuar rregullorja e këtij program studimi, me qëllim konsiderimin e gjuhës angleze (dhe gjuhëve të tjera) si kriter hyrës në këtë program studimi.</p>

<p>dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Institucioni përthith idetë që vijnë nga fokus grupet, diskutimet me studentët, me ish studentët dhe me bordet e punës. <i>Megjithatë nuk rezultojnë që tejkritereve ligjore të jenë përcaktuar kritere të tjera.</i></p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve; Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion; Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Si rezultat i diskutimeve në fokus grupe me studentët dhe me bordet e punës, por edhe me strukturën e institucionit, studentët kanë informacion për mundësitë e punësimit.</p> <p>Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit, akreditimin e programit të studimit, si edhe kanë këshillim karriere.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar; Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik; Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna të plota në lidhje me studentët pjesë e programit, ecurinë e tyre, tërheqjen dhe transferimin. Ky informacion u konsultua në institucion dhe disa herë mbi baza kampioni u kontrolluan dhe dosjet e vetë studentëve. Rezultoi se informacioni ishte i plotë dhe lehtësisht i aksesueshëm.</p> <p><i>Në regjistrin themeltar të verifikuar gjatë vizitës, GVJ konstatoi se shumë studentë nuk ishin të pajisur me numra matrikullimi. Pas verifikimeve edhe të komunikimit me AKP, u deklarua dhe verifikua në sekretari se numrat e matrikullimit ishin të gjitha por nuk ishte përditësuar regjistri.</i></p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre; Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni mban një bazë të dhënash për punësimin e të diplomuarve të saj. Ky informacion është vënë në dispozicion të ekspertëve edhe nëpërmjet dokumentit "Të dhënat për punësim". Gjithashtu institucioni ka informacion edhe për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit; Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të rregullt për programin e studimit, organizimin e tij, si nëpërmjet faqes së internetit ashtu edhe nëpërmjet broshurës së përgatitur për këtë qëllim. Gjithashtu studentët informohen edhe për vlerësimin e tyre.</p> <p>Në çdo rast, pas çdo forme vlerësimi, studentët kanë të drejtën e konsultimit me pedagogun e lëndës, kjo në përputhje me pikën 28.7 të Rregullores së institucionit. Sipas këtij parashikimi rezultojnë se pedagogu ka të drejtë që të ndryshojë vlerësimin e tij, duke argumentuar në fletën e provimit arsyet e ndryshimit. Vlerësimi përfundimtar i dorëzohet më pas sekretarisë. Megjithatë nga intervista me studentet rezultoi se <i>një pjesë e pedagogëve pranonin vetëm që të bënin ndryshime të vogla në vlerësim, megjithëse mund të rezultonte se vlerësimi nuk ishte bërë i plotë. Në këtë drejtim rekomandojmë zbatimin më me transparencë të rregullores së institucionit.</i></p>

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet strukturave të tij, ndjek dhe këshillon vazhdimisht studentët në problematikave që ato hasin.</p> <p>Nga takimi që GVJ realizoi me studentët rezultoi që praktika mësimore zhvillohet sipas kërkesës së studentëve dhe jo sipas një plani të hartuar nga ana e institucionit. Në përfundim të praktikës mësimore, studenti plotëson detyrimet e tij në lidhje me praktikën që ka ndjekur dhe vlerësohet nga një komision. Institucioni vetë nuk ofron mundësi përzgjedhjeje.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Studentët për tu pranuar në këtë program studimi Msc “E Drejtë Private dhe Biznesi” rezultojnë të kenë përfunduar dhe fituar diplomën përkatëse të ciklit të parë (Bachelor) të fituar në një universitet brenda ose jashtë vendit; diploma e ciklit të parë rezultoi në të njëjtën fushë studimi. Kriteri i gjuhës së huaj nuk ka qenë një kriter hyrës për këtë program. Sipas rregullave në fuqi, ky tashmë është një kriter hyrës dhe institucioni rekomandohet që të përditësojë rregulloren përkatëse të pranimit në lidhje me sa më sipër. 2. Nëpërmjet diskutimeve në fokus grupe të studentëve si dhe ato me bordet e punës, strukturat e institucionit informojnë studentët për mundësitë e punësimit. 3. Institucioni nëpërmjet strukturave të tij ndjek, këshillon dhe informon studentët në lidhje me zhvillimin e praktikave profesionale. 4. GVJ rekomandon përditësimin e rregullores së programit të studimit. 5. GVJ rekomandon përcaktimin e kriterëve të tjera shtesë për pranimin e studentëve, tej atyre të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. 6. GVJ rekomandon që të dhenat e studentëve në rregjistrat përkatës të jenë të plota duke përfshirë dhe numrin e matrikullimit të studentëve, të cilat megjithëse disponohen nga institucioni nuk janë pasqyruar në regjistër. 	
<u>Standardet plotësohen plotësisht.</u>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Për qëllime të organizimit të kërkimit shkencor, Institucioni ka krijuar pozicionin e zëvendësrektorit për kërkimin shkencor, i cili ka si detyrë koordinimin e të gjitha hallkave dhe njësive në funksion të kërkimit shkencor.

Në përgjithësi puna individuale e secilit prej anëtarëve të personelit akademik, publikohet në Revistën e Fakultetit “Polis”. Për këtë Revistë nga ana e institucionit arsimor na është vënë në dispozicion dokumenti, ku rezultoi bordi që është ngritur. Kjo revistë botohet në gjuhën angleze dhe është shumë e gjerë, duke përfshirë tematika në fushën e shkencave humane në përgjithësi dhe jo vetëm në fushën e drejtësisë. Në këtë dokument dallohen edhe politikave dhe kriteret që duhet të plotësojnë personat që synojnë të botojnë në të. Revista është e pajisur me ISSN. Informacion në lidhje me këtë revistë gjendet edhe në faqen e internetit të institucionit.

Institucioni organizon rregullisht edhe Konferenca Shkencore me karakter Kombëtar dhe Ndërkombëtar. Një pjesë e këtyre Konferencave përmenden edhe në RVB. Kjo tregon për një jetë aktive akademike. Një pjesë e këtyre konferencave kanë shërbyer edhe për stafin akademik, me qëllim rritjen e kualifikimit të tyre akademik dhe plotësimin e kriterëve për marrjen e gradave/titujve shkencorë. Është detyrë e departamenteve që në fillim të çdo viti akademik të paraqesin kalendarin e aktiviteteve shkencore që do të zhvillojnë.

Nga vizita në institucion por edhe nga dokumentacioni i paraqitur, më vonë, rezultoi që për realizimin e konferencave shkencore ka akte që rregullojnë, organizimin dhe funksionimin e tyre. Këto akte kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit të këtyre konferencave, thirrjet për pjesëmarrje, etj.

Pavarësisht suportit financiar që përmendet në RVB, si nga dokumentacioni i paraqitur ashtu edhe nga vizita në institucion, rezultoi se personeli akademik, në përgjithësi, nuk kishte monografi, studime/botime (në formë teksti) të cilat do të mbështesnin më tej këtë program studimi. Duke qenë se kjo ka qenë edhe një nga rekomandimet e Këshillit të Akreditimit, *sugjerojmë që personeli akademik të mbështetet dhe të nxitet në botimin e studimeve, monografive apo botimeve të tjera.*

Pavarësisht se në RVB përmenden disa projekte (fq.6, 11, 12, 54, 55), rezulton se asnjëri prej tyre nuk është i lidhur me këtë program studimi. I vetmi projekt kërkimor i madh është UET Research 2020, i financuar nga vetë UET dhe në të cilin personeli akademik në këtë program studimi, ka nënpjesët e tij në të cilat duhet të kontribuojë në të ardhmen.

Institucioni ka krijuar edhe një sistem kontrolli hierarkik, i cili ka si synim hartimin, kontrollin dhe rritjen e mbikqyrjes në fushën e kërkimit shkencor. Më konkretisht, hierarkisht struktura paraqitet si më poshtë:

Senati Akademik, sipas statutit të UET, ka ndër të tjera si kompetencë që të miratojë planin vjetor të veprimtarisë akademike dhe të kërkimit-shkencor, garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë, si edhe krijon mekanizma për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, (neni 19.2.7, gërmat “e”, “h” dhe “i”).

Rektorati është një tjetër strukturë e cila ka të drejtë që të paraqesë rekomandime për projektet dhe kërkimin shkencor si edhe monitoron vazhdimisht rezultatet e veprimtarisë së IAL-së (Statuti, neni 19.3.1, gërmat “e” dhe “g”).

Dekanati ka të drejtë që t’i propozojë Senatit programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor, si edhe ndryshime në programet ekzistuese, si edhe shqyrton dhe miraton raportin e Dekanit për veprimtarinë mësimore dhe të kërkimit shkencor (Statuti, neni 19.5.2, gërmat “d” dhe “j”).

Rektori, i cili drejton procesin akademik dhe shkencor në UET, garanton lirinë e kërkimit shkencor, organizon kontrolle për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit-shkencor, administron kërkimin shkencor (Statuti, neni 20.3.4, gërmat “d”, “i”, “j” dhe “k”).

Dekani i cili organizon dhe drejton aktivitetin mësimore dhe kërkimor-shkencor të fakultetit si edhe raporton në lidhje me to (Statuti, neni 20.4.2, gërmat “f” dhe “i”).

Përgjegjësi i Departamentit, i cili ka në kompetencë që të organizojë, koordinojë dhe drejtojë veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore të departamentit, si edhe bën vlerësimin e pedagogëve, ku përfshihet dhe vlerësimi për aktivitetin kërkimor-shkencor (Statuti, neni 20.5.5, gërmat “a” dhe “f”).

Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore-Shkencore, i cili ushtron kompetencat e tij në lidhje me kërkimin shkencor në nivel universiteti dhe përgjigjet për realizimet e anëtarëve të qendrës (Statuti, neni 20.7.5).

Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sipas nenit 11 të Statutit të UET-së harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm, ku përfshihen edhe fusha e kërkimit shkencor. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UET-së. Në përfundim kjo njësi ka të drejtë të propozojë masa dhe ndryshime konkrete për përmirësimin e cilësisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Të dhënat që kanë të bëjnë me kërkimin shkencor në RVB janë paraqitur në tërësi për të gjithë IAL dhe jo të individualizuara për këtë program studimi.

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Sipas të dhënave të administruara në IAL rezultoi sa më poshtë:

Për vitin akademik 2014-2015 – 186 botime shkencore

Për vitin akademik 2015-2016 – 120 botime shkencore

Për vitin akademik 2016-2017 – 150 botime shkencore

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Megjithëse në RVB përmenden disa projekte të fituara dhe konkretisht për vitin 2015 janë 8 projekte, për vitin 2016 janë 2 projekte, ndërsa për vitin 2017 është një projekt, *nga intervistat e realizuara në institucion rezultoi se asnjëri prej tyre nuk lidhej me këtë program studimi.*

- Numri i projekteve të zbatuara

Megjithëse në RVB përmenden disa projekte të zbatuara dhe konkretisht për vitin 2015 janë 11 projekte, për vitin 2016, janë 5 projekte, ndërsa për vitin 2017 janë katër projekte, nga intervistat e realizuara në institucion rezultoi se asnjëri prej tyre nuk lidhej me këtë program studimi.

- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL janë vetëm për tre vite kalendarike dhe më konkretisht për vitin 2015 janë 3 aktivitete, për vitin 2016 janë 5 aktivitete dhe për vitin 2017 janë 5 aktivitete.

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Sipas të dhënave të administruara për vitin 2015 kanë qenë pjesëmarrës 70 veta, për vitin 2016, 80 veta dhe për vitin 2017, 120 veta.

- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Nuk rezulton që të këtë kërkim shkencor në procesin mësimor në këtë IAL.

- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Sipas RVB rezulton se numri i studentëve të përfshirë është shumë i ulët. Kështu për vitin 2014-2015, janë 4 studentë, për vitin 2015-2016 janë 3 studentë, ndërsa për vitin 2016-2017 janë 10 studentë. Në vetë RVB (fq.66) grupi i vlerësimit të brendshëm e konsideron si një nga pikat e dobëta mos aktivizimin e studentëve në kërkimin shkencor.

- Numri i Çmimeve Kombëtare

Institucioni nuk rezulton të ketë fituar ndonjë çmim kombëtar.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik publikon rregullisht artikuj dhe materiale shkencore për disipinën që mbulon. Këto bëhen si rregull në revistën e institucionit "Polis", por edhe në revista të huaja. Nëpërmjet këtyre botimeve dhe tematikave që trajton, personeli akademik jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës dhe në fushat e tjera të jetës.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje kualifikuar.	edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Programi i studimit është në gjuhën shqipe dhe për gjatë këtyre viteve akademike nuk rezulton ndonjë lëndë apo modul që në këtë program studimi të jetë zhvilluar në anglisht. GVJ u informua gjatë vizitës, në intervistën e realizuar me pedagogët dhe drejtuesit e departamentit, që pedagogët zhvillojnë leksione të hapura në kuadër të tryezave të rrumbullakta me pjesëmarrjen e studentëve në gjuhën angleze, por jo si pjesë e kurrikulës së këtij programi.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij	Për ngritjen profesionale të personelit akademik, institucioni ka organizuar trajnime të ndryshme, të cilat janë pasqyruar në dokumentin "trajnim stafi".

mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Nga vizita në institucion, gjatë intervistës me anëtarët e GVB, u informuam që dy prej anëtarëve të departamentit ishin me studime post-doktorature në vende të huaja, si rezultat i mbështetjes së institucionit..															
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.																
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash për publikimet e studimeve shkencore të personelit akademik. Rezulton që për tre vitet e fundit akademike nga ana e personelit akademik janë realizuar:</p> <table border="0"> <tr> <td>Për vitin akademik</td> <td>2014-2015</td> <td>–</td> <td>186</td> <td>botime shkencore</td> </tr> <tr> <td>Për vitin akademik</td> <td>2015-2016</td> <td>–</td> <td>120</td> <td>botime shkencore</td> </tr> <tr> <td>Për vitin akademik</td> <td>2016-2017</td> <td>–</td> <td>150</td> <td>botime shkencore</td> </tr> </table> <p><i>Siç u theksua më sipër, për tekstet, monografitë dhe librat, të personelit akademik, përgjithësisht ka mungesa. Për rrjedhojë një bazë e tillë të dhënash nuk ekziston.</i></p> <p><i>Institucioni ka një bazë të dhënash për projektet që ndjek, por asnjëri prej tyre nuk ka të bëjë me këtë program studimi.</i></p>	Për vitin akademik	2014-2015	–	186	botime shkencore	Për vitin akademik	2015-2016	–	120	botime shkencore	Për vitin akademik	2016-2017	–	150	botime shkencore
Për vitin akademik	2014-2015	–	186	botime shkencore												
Për vitin akademik	2015-2016	–	120	botime shkencore												
Për vitin akademik	2016-2017	–	150	botime shkencore												
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>																
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni, ka krijuar sistem të ndryshme të shkëmbimit të informacionit midis stafit akademik dhe studentëve. Po kështu janë të ndara përgjegjësit midis strukturave të ndryshme për koordinimin e kërkimit shkencor dhe rritjes së bashkëpunimit. 2. Institucioni ka krijuar një sistem trajnimi dhe kualifikimi të vazhdueshëm për stafin akademik, duke mundësuar rritjen profesionale të PAE. Gjithashtu u evidentua që një pjesë e personelit akademik ndjek dhe studime postdoktorale edhe jashtë vendit. 3. Institucioni ka një bazë të dhënash të plotë për të gjitha botimet shkencore në formë artikuj dhe referimesh të realizuara nga personeli akademik i IAL-së. 4. Nuk rezulton që të ketë projekte kërkimore, për programin e studimit, Msc në të Drejtë Private dhe Biznesi, për periudhën e riakreditimit. 5. Rekomandohet që të nxiten dhe mbështeten pedagogët për të relizuar monografi, botime/studime shkencore në formë teksti. <p><u>Standardet plotësohen krvesisht.</u></p>																

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Institucioni (UET) ka krijuar bashkëpunime me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, në funksion të krimit të mundësive të ndryshme për studentët dhe stafin akademik.

Për këtë arsye rezulton se janë nënshkruar 125 marrëveshje, me IAL të huaja dhe IAL të brendshme, qendra kërkimore si edhe me fondacione, apo institucione brenda dhe jashtë vendit. Këtu mund të përmendim IAL në Austri, Itali, Bullgari, por edhe në Mbretërinë e Bashkuar etj. Në lidhje me këto të dhëna rezultoi se ato të publikuara në RVB përputhen plotësisht.

Pra, rezulton se institucioni ka krijuar një rrjet të gjërë marrëveshjesh me mjaft institucione të administratës publike të komunitetit të biznesit, dhe organizatave jofitimprurëse. Gjithashtu, siç është përmendur në këtë raport, rezulton që çdo departament ka krijuar edhe Bordin e Tregut të Punës, ku janë ftuar të marrin pjesë figura të ndryshme dhe që shërbejnë

për arritje në fushën e programeve të studimit që administrohen nga departamenti. Këto Borde ofrojnë konsulencë për të rritur përputhshmërinë e diplomave me tregun e punës, si dhe për të lehtësuar procesin e praktikave profesionale të studentëve, si edhe punësimin e ardhshëm të tyre.

Institucioni zhvillon çdo vit edhe Panairin e Punës për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të studentëve në to. Institucioni është kujdesur që periudha kohore e zhvillimit të Panairit të Punës, përkon pikërisht me fundin e vitit akademik, me qëllim krijimin e mundësisë për studentët që ndodhen në prag diplomimi.

Institucioni i ka kushtuar rëndësi edhe pjesëmarrjes në disa programe të Bashkimit Evropian, si TEMPUS, NEXT EUROPE etj.. Nga të dhënat statistikore, rezulton se ka pasur programe shkëmbimi si midis pedagogëve ashtu edhe studentët. Megjithatë nga verifikimi në institucion, nuk rezultoi që këto programe të kenë përfshirë studentë të këtij program studimi. Në lidhje me pedagoget u konstatuan vetëm dy raste, kur dy prej tyre, ishin aktualisht me studime post doktorature në Malin e Zi dhe në Rusi.

Gjithashtu, nga vizita në institucion, rezultoi se nuk ka marrëveshje midis IAL-së dhe institucioneve apo organizatave të tjera me qëllim zhvillimin e praktikës mësimore me studentët. Siç është përmendur në këtë raport, rezulton se në këtë rast, është vetë studenti i cili përzgjedh vendin (institucionin) se ku do të realizojë praktikën mësimore (zakonisht vendi i punës ku ai aktualisht punon) më pas ai është i detyruar që të përmbush detyrimet akademike që ka në këtë rast, ku përfshihet edhe dorëzimi i një formulari, si edhe të një “detyre” që ka të bëjë me praktikën mësimore të zhvilluar. Këto akte vlerësohen nga një komision në Departament. Në fund studenti vlerësohet me notë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
 - Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

Sipas të dhënave të paraqitura rezulton se IAL ka pasur vetëm një pjesëmarrës si partner në projekte dhe konkretisht vetëm në vitin 2016. Në lidhje me leksionet dhe/apo seminarat e organizuara me lektorë të huaj rezulton se në përgjatë viteve 2015-2017 ka pasur vetëm 2 raste. Përsa i përket mobilitetit të studentëve, rezulton se për vitin akademik 2016-2017 ka pasur një student i huaj që ka ardhur në këtë IAL dhe një student i këtij institucioni i cili ka levizur jashtë. Gjithashtu institucioni ka marrë pjesë në aktivitete shkencore jashtë vendit në 2 raste.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
 - Institucionet qeveritare bashkëpunuese
 - Organizatat Profesionale
 - Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se Universiteti Evropian i Tiranës ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi më disa institucione dhe konkretisht:

Rezulton se UET ka marrëveshje bashkëpunimi me 94 IAL të huaja. Këto marrëveshje kanë të bëjnë me realizimin e projekteve evropiane si Erasmus, Tempus, Sigma etj., shkëmbimin e studentëve dhe të stafit akademik, si edhe forma të tjera bashkëpunimi.

Gjithashtu rezulton se UET ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me 15 IAL në Shqipëri. Edhe në këtë rast marrëveshjet e bashkëpunimit synojnë realizimin e projekteve evropiane por edhe forma të tjera bashkëpunimi.

UET ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me 17 institucione të tjera, të cilat janë organe të administratës publike, si Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, ambasada të huaja, dhe pjesa tjetër janë organizata të ndryshme.

(Për më gjerë shih RVB, fq.58-63)

Por pavarësisht këtyre marrëveshjeve, referuar të dhënave që ka deklaruar vetë IAL, rezulton që ato të mos jenë funksionale. Kjo duket në bashkëpunimet e pakta në fushën e projekteve, në shkëmbimin e studentëve dhe të stafit

akademik, si edhe në format e tjera, të cilat mbeten në nivele të ulta. Gjithashtu asnjëra prej këtyre marrëveshjeve, siç është shpjeguar edhe më sipër nuk është në funksion të zhvillimit të praktikës mësimore.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, intervista e realizuar me drejtuesit e departamentit si edhe nga takimi me studentët, GVJ u informua që studentët preferonin ta zgjidhnin vetë vendin/institucionin ku donin të kryenin praktikën profesionale. Disa prej studentëve, edhe pse nuk donin të vepronin në këtë mënyrë, ndiheshin të detyruar, pasi universiteti nuk ofronte në mënyrë të pavarur institucionet ku mund të zhvillohej praktika.</p> <p>Nga informacioni i paraqitur në RVB (faqja 64), është deklaruar që UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. Vitin e fundit akademik (2016-2017) rezultoi që institucioni nuk ka ndjekur praktikën e viteve të mëparshme, në lidhje me marrëveshjet paraprake me institucionet ku studentët mund të zhvillojnë praktikën profesionale. Institucioni ka aplikuar formën e dhënies së rekomandimit për studentin tek institucioni që ai dëshiron të ndjek praktikën duke ofruar një mbështetje institucionale.</p> <p><i>GVJ rekomandon që marrëveshjet paraprake që institucioni mund të lidhë me institucionet publike apo private, në çdo rast do të mund të orientonin, lehtësonin dhe ndihmonin studentët në përzgjedhjen e institucionit të duhur.</i></p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Informacioni shkëmbehet rregullisht midis anëtarëve të personelit akademik, si edhe ka një bashkëpunim të mirë, i cili rezultoi i dukshëm nga organizimi i konferencave, simpoziumeve, botimeve në Revistë etj.</p> <p>Ka një ndarje të detyrave midis anëtarëve të personelit akademik e cila mundëson marrjen e përgjegjësisë dhe garanton bashkëpunimin midis stafit akademik. Po kështu drejtuesit e departamenteve kanë përgjegjësi të qarta në nxitjen dhe vlerësimin e kërkimit shkencor nga stafet e tyre akademike.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga ana e Institucionit, ka një sërë marrëveshjesh më qëllim realizimin e objektivave të këtij program studimi.</p> <p>Siç është trajtuar më sipër, institucioni nuk ka marrëveshje të mirëfillta me punëdhënësit për kryerjen e praktikës mësimore. Është vetë studenti që zgjedh vendin ku do të realizojë praktikën, zakonisht në vendin e punës që ai ka aktualisht dhe për këtë përmbush detyrimet përkatëse dhe më pas vlerësohet.</p> <p>Institucioni ka realizuar pjesëmarrjen me disa lektorë të ftuar por ato mbeten në nivele të vogla. Rregullisht nga strukturat e Institucionit, hartohen raporte analitike në funksion të programeve të studimit.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Grupi i vlerësimit të jashtëm vëren se institucioni ka krijuar një rrjet të gjërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione akademike, administrative dhe private të ndryshme. Gjithashtu nëpër institucione janë krijuar dhe organizma të posaçëm, sic janë Bordet e Punës të cilat, për shkak të përbërjes që ato kanë ndihmojnë dhe rrisin bashkëpunimin e këtij institucioni me aktorë të ndryshëm.

2. Institucioni bën përpjekje të shumta për rritjen e formave të bashkëpunimit dhe rritjen e punësimit të studentëve që diplomohen pranë tij. Por, GVJ konstaton që institucioni nuk ka asnjë marrëveshjeve, me institucione apo organizata dhe që kanë të bëjnë më zhvillimin e praktikës mësimore në mënyrë më të përqendruar dhe sipas nevojave të tregut të punës.

Standardet plotësohen kryesisht.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats- pengesat).

a. Pika të forta:

- 1) Vlerësohet pozitivisht botimi periodik i revistës shkencore "POLIS" (e pajisur me ISSN dhe me "double blind peer review").
- 2) Vlerësohet pozitivisht aplikimi i metodës së vlerësimit të stafit nga stafi (*peer to peer*), pasi nxit frymën e bashkëpunimit dhe ndërveprimin ndërmjet trupës akademike.
- 3) Vlerësohet pozitivisht përdorimi i sistemit antiplagjaturë EPHORUS, për të përmirësuar cilësinë e punës së studentëve dhe kontrollin për citime të pahijshëm ose plagjiaturë duke e krahasuar atë me bazën akademike të të dhënave.
- 4) Vlerësohet pozitivisht përdorimi i sistemit LMS (Learning Management System) si një instrument strukturor mjaft i mirë akademik, i cili ndihmon studentët dhe stafin në administrimin dhe vlerësimin e punës akademike.
- 5) Vlerësohet pozitivisht publikimi i "Guida e Studentit", e cila synon të informojnë në lidhje me rregullat dhe funksionimin e jetës akademike.
- 6) Autoritetet drejtuese të institucionit janë të nxitur për të qenë transparentë në të gjithë komponentët e procesit mësimor.
- 7) Vlerësohet pozitivisht krijimi dhe funksionimi i "Fokus Grupeve" me studentët ekselentë, të cilët realizojnë komunikimin mes tyre, stafit akademik dhe drejtuesve të institucionit. Këto grupe mundësojnë prezantimin e problematikave të studentëve në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor si dhe çështje që ata çmojnë të arsyeshme për t'ju bërë me dije drejtuesve të programit dhe të institucionit.

b. Pika të dobëta:

- 1) Për vitin akademik 2014-2015, personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në këtë program studimi nuk ka realizuar peshën e duhur akademike në funksion të këtij programi.
- 2) Titullarari i lëndës në këtë program studimi nuk është gjithnjë një pedagog efektiv (PAE). Titullarët e lëndëve nuk janë të gjithë personel akademik efektiv edhe pse angazhimi i personelit akademik me kontratë në rolin e titullarëve të lëndëve përbëhet nga pedagogë që mbajnë tituj dhe grada shkencore.
- 3) Mungesa e zhvillimit të praktikës profesionale mbi bazën e marrëveshjeve zyrtare të lidhura nga ana e institucionit me institucionet apo organizatat e biznesit.
- 4) Mos angazhimi i një numri më të madh të personelit akademik në funksion të mbikqyrjes së praktikës profesionale (vetëm një pedagog është angazhuar për mbikqyrjen e praktikave profesionale).
- 5) Institucioni nuk ka realizuar një studim specifik të nevojave të tregut të punës në fushën përkatëse të këtij programi studimi.
- 6) Mos përfshirja e studentëve (të ciklit të dytë) me punimet e tyre/tema masteri në botimet shkencore të universitetit.

c. Mundësitë:

- 1) Institucioni ka një kapacitet akademik të mjaftueshëm për të angazhuar më shumë personel akademik efektiv (PAE) në realizimin e këtij programi studimi si në drejtim të procesit akademik ashtu dhe në funksion të praktikës profesionale.
- 2) Revista Shkencore periodike që nxjerr universiteti mund të publikoj punimeve shkencore më të spikatura të studentëve. Kjo mundësi që ka institucioni mund të nxisë punën e studentëve më të mirë të këtij departamenti që në bashkëpunim dhe me profesorët e tyre të përballen me një lexues të kualifikuar.

d. Pengesat:

Nuk konstatojmë asnjë pengesë për të mënjanuar pikat që vlerësuam si "pika të dobëta".

Rekomandime:

- 1) Shpërndarjen e peshës së krediteve në dy vitet akademike në mënyrë të barabartë.
- 2) Përditësimi i rregullores së programit të studimit.
- 3) Përcaktimi i kritereve shtesë për pranimin e studentëve, tej atyre të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- 4) Të dhënat e studentëve në regjistrat përkatës të përditësohen në çdo kohë (numri i matrikullimit të studentëve megjithëse disponohej nga institucioni nuk ishte pasqyruar në regjistër).
- 5) Praktika profesionale duhet të koordinohet dhe me drejtuesin e temës së diplomës në mënyrë që ajo të shërbejë dhe si një mjedis në të cilin studenti të grumbullojë eksperiencën e duhur për përgatitjen e saj.
- 6) Institucioni duhet të bëjë më shumë përpjekje për aktivizimin dhe rritjen e funksionalitetit të marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit që ka, për zhvillimin e kërkimit shkencor, realizimin e projekteve të ndryshme, shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve në funksion dhe të këtij programi studimi.
- 7) Bordi Shkencor i revistës duhet të ketë në fokus të tij dhe nxitjen e kërkuesve për të trajtuar problematikat ligjore që të mund të trajtohen nga stafi akademik i këtij programi studimi si dhe nga ekspertë të fushës, për të nxitur dhe rritur cilësinë e debatit juridik.
- 8) Nxitjen e personelit akademik në hartimin e monografive dhe teksteve studimore, në funksion të këtij programi studimi.

SUMMARY ANALYSIS ON THE IMPLEMENTATION OF THE MASTER PROGRAMME

a. Strength Points:

- 1) It is positively evaluated the periodical publication of the scientific journal "POLIS" (with ISSN and "double blind peer review").
- 2) It is positively evaluated the implementation of the "peer to peer" evaluation method as it encourages the spirit of cooperation and interaction between academic staff.
- 3) It is positively evaluated the application of the EPHORUS program to improve the quality of student work and control of improper citation or plagiarism by comparing it with the academic database.
- 4) It is positively evaluated the implementation of Learning Management System (LMS) as a highly structured academic tool that helps students and staff in administration and evaluation of academic work.
- 5) It is positively evaluated the publication of the "Student Guide", which aims to inform about the rules and functioning of academic life.
- 6) Institution authorities are encouraged to be transparent in all components of the learning process.
- 7) It is positively evaluated the performance of "Focus Groups" with excellent students. These groups enable the presentation of student issues related to the development of the learning process as well as the issues they deem reasonable to raise awareness of program and of the institution authorities.

b. Weak Points:

- 1) For the academic year 2014-2015, the full time professors part of this study program have not had the academic load required by the standards.
- 2) The first course lecturer in the subjects of this study program is not always the full time professor (PAE). In some of the courses, part-time professors are the first lecturers although they have academic titles.
- 3) Lack of institutional agreements in fulfilling the professional practice of students.
- 4) There is not a large number of academic staff involved in supervising the professional practice of students (only one academic staff is the student supervisor).
- 5) No specific "market study" has been undertaken by the institution in the relevant field of this study program.
- 6) Master program students are not involved with their academic works / master theses in university scientific publications.

c. Opportunities:

- 1) The institution has a sufficient academic capacity to engage more effective academic staff (PAE) in the realization of this study program both in terms of the academic process and in the function of the professional practice of students.
- 2) The University's periodical scientific journal can publish the most prominent scientific works of students. The potential of this institution can spur the work of the best students of this program, who in cooperation with their professors may face qualified readers.

d. Threats:

No identified obstacles.

Recommendations:

- 1) Distribution of the number of credits proportionally during the two academic years.
- 2) Updating the study program regulation.
- 3) Determination of additional criteria for admission of students, beyond those determined by the legislation in force.
- 4) The updating of student records in the relevant registers (the number of students matriculation although available from the institution was not reflected in the relevant register).
- 5) The student's professional practice should be coordinated with the supervisor of the diploma thesis in order to better serve as an environment in which the student will accumulate the right experience for the preparation of the master thesis.
- 6) The institution should make more efforts to activate and enhance the functionality of various cooperation agreements, the development of scientific research, the realization of various projects, exchange of academic staff and students in function of this study program.
- 7) The journal's Scientific Board should focus on and encourage researchers to address the legal issues that can be addressed by the academic staff of this study program as well as by field experts to promote and enhance the quality of legal debate.
- 8) Encouraging academic staff in compiling monographs and textbooks, in function of this study program.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. As. Dr. Enkeleda OLLDASHI

Doc. Dr. Erind MERKURI